



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Organizimi i Mjedisit Edukativ

në Institucione të Edukimit në Fëmijërinë
e Hershme dhe në Klasa Parafilllore në Shkolla





REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Organizimi i Mjedisit Edukativ në Institucione të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe në Klasa Parafilllore në Shkolla





Dokumenti është zhvilluar me mbështetjen e **UNICEF në Kosovë**
www.unicef.org/kosovoprogramme

Përmbajtja

HYRJE	5
SI MUND TA KUPTOJMË ROLIN E MJEDISIT NË EDUKIMIN E FËMIJËVE NË FËMIJËRI TË HERSHME?	6
ORGANIZIMI I MJEDISIT NË INSTITUCIONE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME DHE KLASA PARAFILLORE	7
ORGANIZIMI I MJEDISIT TË BRENDSSHËM	9
ORGANIZIMI I DHOMAVE/KLASAVE NË GRUP-MOSHAT 0-2 DHE 2-3 VJEÇ	12
ORGANIZIMI I DHOMAVE/KLASAVE PËR GRUP-MOSHAT 3-6 DHE 5-6 VJEÇ	15
ORGANIZIMI I MJEDISIT TË JASHTËM	26
ORGANIZIMI I MJEDISIT NË KLASAT PARAFILLORE	29
ORGANIZIMI I MJEDISIT TË BRENDSSHËM	29
ORGANIZIMI I MJEDISIT TË JASHTËM	30
PËRDORIMI I HAPËSIRAVE TË PËRBASHKËTA KOMUNITARE	30
UDHËZIME PËR KRIJIMIN E MJEDISIVE MIQËSORE – ROLI I EDUKATORES	30
KRIJIMI I KONTEKSTEVE TË TË NXËNIT NË MJEDIS	31
TRANSFORMIMI I MJEDISIVE	34
SI TË REFLEKTOJMË MBI MJEDISIN E TË NXËNIT?	39
FALËNDERIME	40



Fotografia 1.
Fëmijët duke zhvilluar aktivitete me materialet të natyrës,
Institucioni Parashkollor Shkronjat, Prishtinë.
© UNICEF/2024/S.Karahoda

Ky udhëzues mbështetës për zbatimin praktik të Kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë për fëmijët 0-6 vjeç ka për qëllim të ndihmojë edukatorët/et dhe të gjithë palët e përfshira në ofrimin e shërbimeve në fëmijëri të hershme me qëllim të ofrimit të një mjedisi cilësor në funksion të mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve.

Sot gjithnjë e më shumë po konstatohet fakti që ofrimi i një mjedisi të sigurt në aspektin socio-emocional, gjithëpërfshirës, dhe stimulues në pikëpamje të mbështetjes dhe zhvillimit holistik të fëmijës është krucial në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës përgjithësisht.

Zhvillimi i kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme për moshat zero deri në 6 vjeç krijon një bazë të fuqishme dhe parashtron udhëzime për organizimin e hapësirave të institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme në menyrë që lehtësojnë dhe inkurajojnë lojën, zhvillimin dhe arritjen e kompetencave të përcaktuara në kurrikulë.

Për më tepër, një numer i fëmijëve në Kosovë pjesën aktive të ditës e kalojnë në institucione të edukimit në fëmijërinë e hershme apo shkolla (niveli parafillor – mosha 5 vjeç). Prandaj, këto institucione duhet të përpiqen sa më shumë që të sigurojnë një mjedis i cili është në përshtatshmëri të interesave dhe nevojave zhvillimore dhe edukative të fëmijës. Këto paraqesin edhe pikënisjen dhe rëndësinë e zhvillimit të këtij Udhëzuesi praktik, i cili synon që të ndihmojë në punën e tyre profesionistët e edukimit në fëmijërinë e hershme, përfshirë personelin edukativ, bashkëpunëtorët profesional, administratorët dhe stafin mbështetës, por edhe politikë bërësit dhe vendim-marrësit duke kuptuar më mirë nevojat për krijimin e mjedisit në mbështetje

të zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve.

Duke ofruar shërbime të specializuara, shpeshherë pritët që institucionet e edukimit në fëmijëri të hershme (EFH) të shërbejnë edhe si një nxitës i ofrimit të një mjedisi miqësor edhe në hapësirat brenda familjes, duke ofruar këshilla për prindërit/kujdestarët ligjor të fëmijës mbi interesat dhe nevojat e fëmijës.

Duke njohur rëndësinë e mjedisit dhe mundësive zhvillimore që ai ofron, edukatorët në vazhdimësi duhet të përpiqen që hapësirat fizike (si ato të brendshme ashtu edhe ato të jashtme) të jenë në përputhje me interesat e fëmijës për të hulumtuar dhe zhvilluar të nxëniet e tyre.

Përmes vëzhgimit, edukatorët arrijnë të identifikojnë se cilat mjedise janë më të frekuentuara dhe cilat mjedise kanë nevojë për riorganizim. Ata/ato kuptojnë mjedisin si një hapësirë dinamike e cila në vazhdimësi ndryshon duke ofruar stimuj të rinjë dhe fenomene për zbulime të reja.

Lodrat/mjetet dhe materialet të cilat gjenden në institucion të EFH-së marrin jetë vetëm atëherë kur përdorimi i tyre udhëhiqet nga interesat e fëmijës. Krijimi i mjedisve të cilat janë të sigurta në aspektin e përdorimit dhe stimuluese në krijimin e mundësive të reja për të nxënë paraqesin parakushtet e krijimit të një mjedisi cilësor në funksion të mirërritjes, zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve.

Le të përpiqemi të gjithë së bashku të kuptojmë fëmijën dhe kompetencën e tij/saj në krijimin e rrugëve të reja njohëse dhe të jemi aty ta mbështesim fëmijën përmes përgatitjes së mjedisit dhe ofrimit të mundësive të ndryshme njohëse.


SI MUND TA KUPTOJMË ROLIN E MJEDISIT NË EDUKIMIN E FËMIJËVE NË FËMIJËRI TË HERSHME?

Mjedisi i të nxënit luan një rol të rëndësishëm në cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga institucionet e EFH-së dhe klasat parafillore në shkolla. Ai i referohet aspektit të hapësirave, materialeve, pajisjeve, rutinave dhe aktiviteteve që edukatorët dhe prindërit/kujdestarët ligjor mund t'i zhvillojnë në mënyrë të qëllimshme, për të mbështetur të nxënit e fëmijëve në të gjitha fushat e zhvillimit.

Meqenëse të nxënit është një proces shumë

dimensional i cili nuk mund të kufizohet brenda një kohë dhe mjedisi të caktuar, edukatorët krijojnë një partneritet të qëndrueshëm me prindërit/kujdestarët e fëmijëve, që të nxënit të jetë një proces i vazhdueshëm që fillon në mjediset e institucionit parashkollor dhe vazhdon në familje/komunitet, apo nga familja/komuniteti fillon e zgjerohet në institucion të EFH-së/klasë parafillore.

Për të dizajnuar një mjedis të të nxënit në mënyrë sa më cilësore atëherë duhet të përqëndrohemi në tre aspektet kryesore që kanë të bëjnë me **mjedisin fizik¹**, **mjedisin social** dhe **organizimin e kohës**.



1 VanAken, A. (2020). The temporal, social, and physical environment as applications of the whole child tenets in early childhood. [Column]. Lutheran Education Journal, <https://lej.cuchicago.edu/columns/supporting-the-temporal-social-and-physical-environments-of-young-children/>



Fotografia 2.
Foshnja duke hulumtuar lodrën e tij.
© UNICEF/2011/ S.Karahoda

ORGANIZIMI I MJEDISIT NË INSTITUCIONE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME DHE KLASA PARAFILLORE

Mjedisi në secilin institucion të edukimit në fëmijërinë e hershme (EFH) dhe klasa parafillore në shkolla (KP) përfaqëson një identitet apo vlerë të veçantë e cila e bënë një institucion të jetë i veçantë nga një tjetër institucion i EFH-së apo KP.

Mjedisi përmban brenda vetes dhe përfaqëson edhe vlerat e komunitetit në të cilin ai gjindet. Kjo veçanti lejon që institucionet e EFH-së të frymojnë dhe komunikojë lehtësisht me komunitetin sepse vlerat në të janë të transferueshme.



Fotografia 3.
Plani dhe oborri i institucionit parashkollor, Rrufc, Lipjan.
© UNICEF/2024

Pavarësisht, veçantive dhe tipareve dalluese që mund të ketë secili institucion, ndër karakteristikat e përbashkëta të cilat i gjejmë të pasqyruara në të gjitha institucionet e fëmijërisë së hershme kanë të bëjnë me:

- krijimin e një mjedisi të qasshëm, gjithpërfshirës për të gjithë fëmijët,
- krijimin e një bilanci në mes të kërkesave individuale të fëmijës dhe nevojave grupore,
- zhvillimin e aftësive shprehëse dhe kultivimin e kreativitetit,
- respektin ndaj njëri-tjetrit,
- respektin për familjen dhe përfshirjen e një komuniteti më të gjërë,

- vëzhgimin, mbështetjen dhe simulimin e proceseve njohëse të fëmijës,
- të kuptuarit dhe ndihmën në menaxhimin e emocioneve, temperamentit e ndenjave të fëmijës, duke i lejuar që vetë fëmijët të jenë protagonistët apo rolet kryesore në procesin e tyre të të nxënimit².

Prandaj, mjedisi duhet të konceptohet si një vend shumëndijor, jo vetëm thjesht i pasur me stimuj, por me vlera të ndryshme shqisore, në mënyrë që çdo fëmijë e individ të mund të përshtatet bazuar në pritshmëritë dhe karakteristikat e saj/tij personale.³

2 Edwards, C., Gandini, L., & Forman, G., (2012). The hundred languages of children: the Reggio Emilia Experience in transformation. Third editions. Praeger.

3 Ceppi & Zinni (2008). Children, space, relations: metaproject for an environment for young children. Reggio Children: Domus Academy Research Center

ORGANIZIMI I MJEDISIT TË BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm nuk ndërlidhet vetëm me organizimin e hapësirës brenda dhomave por ai duhet të reflektojë në tërë institucionin e EFH-së apo KP. Përmes organizimit të hapësirës, institucioni duhet të krijojë identitetin e tij dhe vlerat të cilat ai institucion i përfaqëson. Një organizim i mirë i hapësirës mundëson që institucioni parashkollor më lehtësisht të kryen aktivitetin e tij të përditshëm në punën me fëmijët, të edukatoreve me njëra-tjetrën dhe më me lehtësi komunikon me prindërit/kujdestarët e fëmijëve, komunitetin dhe të gjitha grupet shoqërore të cilat mund të përfshihen aktivisht në veprimtaritë e Institucionit parashkollor.

Në vazhdim po paraqesim një përshkrim të përgjithshëm për të gjitha hapësirat fizike të institucionit të EFH-së. Disa nga hapësirat nuk janë të aplikueshme për klasat parafillore në shkolla fillore dhe ato kanë të cekur këtë informatë. Insitucionet e EFH-së nuk kanë të njejtën infrastrukturë, prandaj, këtu janë dhënë udhëzime të përgjithshme të cilat mund t'i shërbejnë stafit të institucionit të EFH-së të reflektojë mbi situatën aktuale dhe ta avancojë atë tutje.

HYRJA E INSTITUCIONIT

Hyrja duhet të ofrojë një ndjesi pozitive, të jetë ftuese dhe informuese në të njejtën kohë si për fëmijët, ashtu edhe për prindërit/kujdestarët ligjor. Ajo duhet të jetë e qasshme dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Aty ofrohen buletinet e informacioneve, të rejat e fundit, projektet aktuale të cilat po zhvillohen, kutia e mesazheve/postës, kutia e sygjërimeve, hapësira e pritjes dhe pjesa e ndërrimit të këpucëve, e ndonjëherë edhe pjesa e vendosjes së xhaketave/palltove. Kjo është tejet e rëndësishme për të krijuar urën e parë ndërlidhëse me prindërit/kujdestarët ligjor të cilët sjellin fëmijët në hyrjen e institucionit në baza ditore dhe përmes ekspozimit të informatave dhe dokumentimit të jetesës dhe punës së fëmijëve në institucion, ata mund të bëhen pjesë aktive e kësaj jetese.

Secili fëmijë duhet të ketë hapësirën e tij personale e cila është e identifikueshme lehtë nga fëmija (mund të jetë një fotografi dhe emri i shkruar i fëmijës, mund të jetë një simbol dhe emri) etj. Hapësira e mesazheve është hapësirë e privilegjuar për komunikime dhe shkëmbime personale.

Që fëmijët të jenë më të lirshëm në veprime, mund të ofrohet edhe një hapësirë ku ata mund të ulen për të mbathur dhe zbathur më lehtë këpucët.



Fotografia 4.
Hyrja dhe hapësira për ndrim në
Institucion Parashkollor, Shkronjat, Prishtinë.
© UNICEF/2024/S.Karahoda



Fotografia 5.
Fëmija duke organizuar këpucët e saj në hyrje të institucionit parashkollor,
Shkronjat, Prishtinë. © UNICEF/2024/S.Karahoda

KORRIDORET

Hapi i parë është analiza e situatës aktuale. Si i shfrytëzojmë ne korridoret në Insitucionin e EFH-së ose KP?

- ➔ Në rastet kur korridoret janë të ngushta dhe të gjata ato mund të shërbejnë për të vendosur dollapët personal të fëmijëve që përfshijnë hapësirën për vendosjen e çantave, varjen e xhaketave/palltove, dhe gjërave personale të fëmijës.



Fotografia 6.
Dollapet e fëmijëve të vendosura në korridore, IP Yllkat, Prishtinë.
© UNICEF/2024

- Në rastet kur korridoret kanë hapësira të mëdha ato mund të përdoren për vendosjen e qendrave për aktivitete të përbashkëta në mes të grupeve apo të krijohen qendra të cilat kanë nevojë për më shumë hapësirë dhe lëvizje siç mund të jetë qendra e dramatizimit. Po ashtu mund të krijohen hapësira të cilat mund të shfrytëzohen për pritjen e të ftuarve dhe organizimin e manifesteve të ndryshme apo hapësira eksploruese me tematika të ndryshme.



Fotografia 7.
Qendra e teatrit të vendosur në hapësirë të përbashkët, në korridor të institucionit parashkollor, Ardhmeria Jone, Ferizaj.
© UNICEF/2024

- Nëse në qendër të institucionit është një korridor i madh në formën e një sheshi qendror: kjo hapësirë e përbashkët përdoret për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta në mes të grupeve të ndryshme edukative. Kjo hapësirë është një urë lidhëse në mes të fëmijëve dhe të rriturve të të gjitha grupeve brenda institucionit. Ky shesh ka për qëllim që të bashkojë fëmijët në një komunitet të vetëm, që ata

të mund të komunikojnë me njëri-tjetrin, të bëjnë aktivitete së bashku, të zhvillojnë idetë e tyre rreth një propozimi, etj. Ky shesh përdoret edhe për aktivitetet e përbashkëta me prindërit dhe pjesëmarrësit nga komuniteti, ekspozitat e projekteve, marrjen e vendimeve për çështje të ndryshme nga fëmijët dhe të rriturit, etj. Nga ky shesh krijohen qasjet për përdorimin e të gjitha hapësirave të tjera në institucion të EFH-së ose KP.



Fotografia 8.
Sheshi/hapësira për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të përbashkëta, IP Ardhmeria Jone, Ferizaj.
© UNICEF/2024

Në muret e korridoreve mund të vendoset dokumentimi i punës së bërë nga fëmijët përgjatë kohës së qëndrimit në institucion parashkollor. Muret në koridore paraqesin një kujtesë të punës së bërë përgjatë projekteve të fëmijëve dhe mund të shërbejnë si një nxitje për eksplorime të reja. Çdo fillim vit muret pastrohen nga puna e grupeve paraprake për t'u lënë vendin punës që do të bëhet nga grupet ekzistuese. Ndërsa gjatë vitit ato përditësohen në vazhdimësi në varësi të projekteve të fëmijëve.



Fotografia 9.
Projektet e fëmijëve të shfaqura në muret e IP Shkronjat, Prishtinë.
© UNICEF/2024



Fotografia 10.
Projektet e fëmijëve në hapësirat e jashtme të IP Shkronjat, Prishtinë.
© UNICEF/2024/S.Karahoda

DHOMAT/KLASAT

Dhomat e punës/klasat duhet të jetë të organizuara në përputhje me moshën e grupit edukativ që frekuenton atë mjedis. Të gjitha orenditë, lodrat, materialet dhe rregullimi i tyre duhet të jenë të sigurta për përdorim, në përputhje me moshën dhe nevojat e fëmijës, dhe të jenë lehtë të qasshme për të gjithë fëmijët e përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Organizimi i hapësirës duhet të krijojë mundësi për veprimtari të përbashkëta, veprimtari në grupe të vogla dhe veprimtari individuale.

Përshtatshmëria moshore, njohja e interesave dhe nevojave të fëmijëve si dhe vëzhgimet e vazhdueshme nga edukatorët, ndihmojnë që hapësirat e dhomës/klasës të organizohen në atë mënyrë që të sigurojnë një mjedis i cili ofrohen siguri por në të njëjtën kohë është edhe stimulues dhe nxitës për fëmijën. Organizimi në bazë të qendrave të aktiviteteve ku fëmijët mund të gjejnë materiale të ndryshme për lojë të cilat provokojnë interesat e tyre mund të jetë mënyra e përshtatshme e organizimit të hapësirës.

Organizimi i hapësirës duhet të pasqyrojë idetë, vlerat, qëndrimet dhe kulturat e njerëzve që jetojnë brenda saj në mënyrë që fëmijët të mund të eksplorojnë në gjuhët e ndryshme shprehëse. Gjithashtu mjedisi duhet të jetë dinamik, ai ndryshon dhe plotësohet vazhdimisht sipas interesave që fëmijët kanë. Çdo kënd, çdo material mund të rristrukturohet, risistemohet, ndryshohet sipas interesave më të larta të fëmijës. Ofrimi i materialeve në mënyrë estetike dhe harmonike i mundëson fëmijëve të zhvillojnë ndjesinë mbi të bukurën dhe harmoninë. Brenda klasave ekziston një liri e organizimit të hapësirës sipas nevojave dhe interesave të fëmijëve me kushtin e vetëm që të ofrojë mundësinë për zhvillimin e “100 gjuhëve të fëmijës”.

Mjedisi reflekton metodologjinë që Institucioni përdor (metodologjia Hap pas hapi, metodologjia Reggio Emilia, metodologjia Montessori, etj.) prandaj edhe organizimi dhe emërtimi i qendrave të aktiviteteve bëhet duke marr për bazë qasjen metodologjike që Institucioni i EFH-së ose KP përdor.

Një mjedis i sistemuar, ku çdo gjë ka një vend të caktuar dhe gjërat janë në harmoni me njëra-tjetrën ndihmon në ndërtimin e një klime më të mirë të punës, si për edukatorët por poashtu edhe për fëmijët.

Muret e dhomës nuk është nevoja të jenë të mbingarkuara me punime dhe vizatime. Çdo dekor, lodër, material duhet të ketë një qëllim të caktuar. Nëse një material, vizatim, dekor nuk i shërben një qëllimi të caktuar atëherë ai material nuk e ka vendin në atë mjedis pune.

Puna e fëmijëve duhet të ekspozohet në mure ndërsa posterat me personazhe nuk e kanë vendin në institucionet e EFH-së ose KP-të.

Karriget dhe tavolinat duhet të jenë në lartësinë e fëmijëve dhe të përshtatshme për të gjitha grup-moshat, përfshirë edhe grup-moshën deri në 18 muaj. Raftet duhet të jenë në lartësinë e fëmijëve sipas grup-moshave.



Fotografia 11.
Shembull i organizimit të mjedisit për grupmoshën 0-3 vjeç, IP Shkronjat
© UNICEF/2024



Fotografia 12.
Shembull i organizimit të mjedisit për grupmoshën 4-6 vjeç, IP Zambaku, Prizren
© UNICEF/2024

ORGANIZIMI I DHOMAVE/ KLASAVE NË GRUP-MOSHAT 0-2 DHE 2-3 VJEÇ

Organizimi i dhomës/klasës për fëmijët e grupeve edukative tek fëmijët e moshave 0-2 vjeç dhe 2-3 vjeç duhet të marr për bazë fillimisht nevojat zhvillimore dhe interesat që fëmijët kanë. Të gjitha materialet që i ofrohen fëmijës për lojë dhe ndërveprim duhet të kenë një qëllim të caktuar i cili është në përputhje me interesat zhvillimore të fëmijës. Komunikimi dhe puna e vazhdueshme me familjen mundëson një adaptim më të lehtë të fëmijës në institucion të EFH-së dhe i krijon mundësi edukatorëve që të kuptojnë më lehtë fëmijët në këtë grupmoshë.

Individualizimi i përvojave edukative dhe vëzhgimi i vazhdueshëm i fëmijëve është parakushti kryesor për të krijuar dhe ofruar një mjedis cilësor të të nxënës i cili përfshinë edhe rregullimin e hapësirës fizike, krijimin e klimës së mirë socio-emocinale por edhe përshtatjen e rutinave ditore dhe aktiviteteve të të nxënës në përputhje me interesat dhe nevojat e fëmijës.

Për fëmijët deri në moshën 2 vjeçare dhoma/klasa mund të organizohet duke pasur në mendje përfshirjen e këtyre hapësirave:


Hapësira e lojës

Përfshinë një kënd të dhomës dhe hapësirën e lirë të mesit të dhomës ku vendosen pajisjet të cilat kanë të bëjnë me stimulimin e lëvizjes siç mund të jenë shkallët me parmak, dhe një pjesë të mirë të dhomës ku ka të vendosura rafte të ulëta në lartësinë e fëmijës ku vendosen lodrat dhe materialet e ndryshme për zhvillimin e lojës. Rregullimi i rafteve dhe vendosja e lodrave në to krijojnë mundësi që të krijohen disa zona më të vogla loje.

Disa nga materialet që mund të vendosen në këtë hapësirë:

- Shportë me topa
- Shportë thesari
- Lodra puzzle
- Lodra që përcjellin konceptin e qëndrueshmërisë së objekteve dhe/ose materialeve

- Lodra sensorike
- Lodra me vendosje dhe zhvendosje
- Lodra konstruktive
- Enë të ndryshme për mbushje dhe zbrazje. etj...
- Parmak të mbështetur në mur në lartësinë e fëmijës dhe pasqyrë e vendosur në mur, ndërsa dysHEMEJA duhet të jetë e siguar.



Fotografia 13.
Hapësira e lojës tek grupmosha 3-4 vjeç, IP Zambaku, Prizren.
© UNICEF/2024

Për ta stimuluar dhe përforcuar të ecurit disa nga lodrat që kërkojnë më shumë hapësirë mund të vendosen në mes të dhomës:

- Shkallët me parmak
- Lodër me shtyerje dhe tërheqje
- Karrocë që shtyhet
- Karrocë që tërhiqet



Fotografia 13.
Zhvillimi i muskujve të mëdhenj tek grupmosha 0-2 vjeç, IP Shkronjat, Prishtinë.
© UNICEF/2024

Hapësira e lojës së qetë

Kjo hapësirë përfshinë një kënd të dhomës/klasës ku vendoset një tapetë, një kanape, disa jastëk të përmasave të ndryshme dhe një raft me libra për shfletim për moshën përkatëse, dhe ku mund të ketë edhe disa lodra të buta. Qëllimi bazë i kësaj hapësire është që fëmijët të mund të përfshihen edhe në veprimtari më



Fotografia 14.
Zhvillimi i muskujve të mëdhenjë dhe menaxhimi i rrezikut
në hapësirën e jashtme të lojës, IP Shkronjat, Prishtinë,
© UNICEF/2024

të qeta nëse ata e ndjejnë të nevojshme një gjë të tillë. Poashtu mund të krijohen mundësi për një ndërveprim të edukatores me fëmijën me një fokus më të lartë vetëm në nevojat e një fëmije.



Fotografia 15.
Shembull i këndit të qetë/qetësisë me materiale të buta tek grupmoshat 3-4 vjeç, IP Bardha Academy
©UNICEF/2019

Si në hapësirën e lojës ashtu edhe në atë të lojës së qetë, të gjitha materialet që futen në gojë nga fëmija duhet të vendosen në një shportë të veçantë dhe në fund të ditës të pastrohen dhe të bëhen të gatshme për përdorim të nesërmën. Lodrat për kuarjen e dhëmbëve dhe ato që futen në gojë duhet të jenë të personalizuar për secilin fëmijë.

Hapësira e shtretërve

Hapësira për vendosjen e shtretërve duhet të jetë në pjesën më të qetë të dhomës, shtretërit duhet të kenë një hapësirë në mes të njëritjetërit dhe të jenë të personalizuar. Secili fëmijë duhet të ketë shtratin e tij/saj - përveç higjenës kjo e ndihmon fëmijën të përgatitet më mirë për rutinën e gjumit. Në grupmoshat 2-3 vjeç shtretërit mund të jenë shtretër që palosen dhe zhvendosen, në mënyrë që të krijohet më shumë hapësirë për lojë, por në të dyja rastet personalizimi i shtretërve është esenciale.



Fotografia 16.
Zona e shtretërve të grupit 0-2 vjet të paluara IP Shkronjat Prishtinë
©UNICEF/2024



Fotografia 17.
Hapësira për lojë e lirë grupmoshës 0-2 IP Shkronjat Prishtinë
©UNICEF/2024



Fotografia 18.
Vendosja dhe heqja/ruajtja e shtretërve të lëvizshëm tek grupmoshat 3-4 vjeç, IP Shkronjat, Prishtinë.
©UNICEF/2024

Hapësira e ngrënies

Nëse fëmijët ushqehen brenda në dhomë atëherë duhet të jetë një hapësirë që i dedikohet ushqimit. Përdorimi i karrigeve për ushqim dhe krijimi i mundësive graduale për vetushqyerje janë hapa të mirë drejt pavarësisht të fëmijës. Tërë veprimtaria që fëmija bënë gjatë kohës së qëndrimit në Institucion e EFH-së, përfshirë lojën, ndërveprimin me materialet, me bashkëmoshatarët, me të rriturit, ngrënien, fjetjen, ndërrimin, janë aktivitetet përmes së cilave fëmija rritet dhe zhvillohet prandaj çdo përfshirje e fëmijës është me rëndësi për të.

Fillimisht duhet të paraqiten ushqimet që hahen me gishtërinje dhe më pas të fillohet përdorimi i lugëve të përshtatshme për moshën e fëmijës. Krijimi i rutinës për larjen e duarve para dhe pas, dërgimi i enës në vendin përkatës dhe pastrimi i hapësirës, janë të gjitha janë aktivitete në të cilat fëmija përfshihet aktivisht. Nëse kjo rutinë fillohet qysh herët në moshën 2-3 vjeç fëmija është në gjendje që jetë mjaftueshëm i/e pavarur në këtë proces.



Fotografia 19.
Hapësira e ngrënies në korridor të IP Ardhmëria Jonë, Ferizaj.
© UNICEF/2024

Hapësira e ndërrimit dhe pastrimit

Hapësira për ndërrimin e fëmijës duhet të jetë në një kënd të dhomës ku është afër me duarlarësen. Nëse institucioni e ka infrastrukturën e nevojshme, kjo hapësirë mund të jetë e ndarë. Fëmija duhet të përfshihet aktivisht edhe në rutinën e ndërrimit me qëllim që ata gradualisht të pavarësohen. Hapësira për ndërrim mund të ketë anash saj një pasqyrë që mundëson që fëmija të shoh vetveten. Ndërsa gjatë këtij procesi komunikimi i vazhdueshëm i edukatores me fëmijën është shumë i rëndësishëm. Në grupmoshat 2-3 vjeç përdorimi i tualetit është i domosdoshëm në mënyrë që fëmijët të pavarësohen në krijimin e shprehisë për përdorimin e tij.

Duarlarëset, tualetet duhet të jenë në lartësinë e fëmijëve dhe të qasshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të mos ketë barriera infrastrukturore. Për të lehtësuar procesin dhe për ta bërë atë të qasshëm për të gjithë fëmijët vendosja e fotografive udhëzuese dhe udhëzimet praktike të individualizuara do të ndihmojnë në krijimin më të lehtë të shprehive higjienike por edhe të tjera.



Fotografia 20.
Duar-larëset e qasshme dhe në lartësinë e fëmijëve për grupmoshën 3-4 vjeç, IP Margherita, Klinë.
© UNICEF/2024

Raftet me rroba

Në varësi të hapësirës e cila është e disponueshme mund të krijohen disa rafte me kartore të vogla të mjaftueshme për gjërat personale të fëmijës. Ato mund të vendosen në afërsi të zonës së ndërrimit me qëllim që të jenë më lehtë të qasshme gjatë ndërrimit të fëmijëve. Ato mund të vendosen edhe në hapësirën në hyrje të dhomës në mënyrë që fëmijët të mund të ndërveprojnë më lehtë. Nëse brenda dhomës nuk ka hapësirë të mjaftueshme atëherë mund të shfrytëzohet pjesa e korridorit në afërsi të dhomës.



Fotografia 21.
Gardarobet e fëmijëve në korridor në afërsi të grupit, IP Zambaku, Prizren.
© UNICEF/2024

ORGANIZIMI I DHOMAVE/ KLASAVE PËR GRUP-MOSHAT 3-6 DHE 5-6 VJEÇ

Në varësi të metodologjisë hapësirat brenda dhomës/klasës mund të marrin emërtime të ndryshme, ato mund të quhen **kënde, qendra, zona** apo **hapësira**. Poashtu ato mund të kenë emërtime të ndryshme si qendra e gjuhës, këndi i mesazheve apo fusha e gjuhës, etj. Këndet në varësi të metodologjisë mund të ndryshojnë. Pothuajse të gjitha këndet kanë një specifikë e cila ndihmon zhvillimin e një fushe dominante por të integruar me fushat e tjera. P.sh. te këndi i mesazheve fëmijët mund t'i dhurojnë njëri-tjetrit një letër, një vizatim, një punim me argjilë, etj. Do të thotë nuk ka një parapërcaktim të asaj se çfarë specifikisht duhet të jetë forma e mesazhit. Fëmija është i lirë për të përzgjedhur. Një kënd ofron veshje dhe materiale të cilat mund të përdoren për dramatizim dhe krijimin

e situatave nga jeta e përditëshme. Në një kënd tjetër ofrohen materiale nga fusha e shkencës dhe mundësive për hulumtim përmes përdorimit të instrumenteve të ndryshme. Në një kënd tjetër ofrohen materiale konstruktuese të madhësive të ndryshme. Në një kënd tjetër ofrohen materiale me të cilat mund të eksperimentohet përmes ditë-hijeve. Çdo gjë është në lëvizje të vazhdueshme bashkë me interesimet e fëmijëve.

Nëse institucioni punon me metodologjinë **Hap pas Hapi**⁴ qendrat bazë që parashihen të jenë kanë të bëjnë me:

- Qendra e artit
- Qendra e blloqeve ndërtimore
- Qendra e gatimit
- Qendra e lojës dramatike
- Qendra e lexim-shkrimit
- Qendra e matematikës
- Qendra e muzikës
- Qendra e shkencës
- Qendra e rërës dhe ujit

Mjediset e jashtme shihen si një vazhdimësi e punës që bëhet në mjediset e brendshme me qendrat si:

- Qendra e rërës dhe ujit
- Qendra e shkencës dhe
- Hapësira e kopshtarisë

Jo të gjitha qendrat duhet të jenë të rregulluara, të pranishme në klasë në të njëjtën kohë – kjo është e paralizueshme me hapësirën e disponueshme dhe numrin e qendrave të mundshme. Prandaj, materialet lëvizin nga njëra qendër tek tjetra në varësi të aktivitetit dhe interesave të fëmijës dhe ato ndryshohen përgjatë vitit në varësi të temave dhe asaj që është aktuale në jetën e fëmijëve.

Nëse institucioni punon me metodologjinë **Montessoriane** organizimi i hapësirës së brendshme për fëmijët e moshave tre deri gjashtë vjeçar korespondon me grupimin e materialeve sipas kësaj ndarje:

- Ushtrimet e jetës praktike (ose jeta e përditëshme);
- Materialet ndijore -përsosje e shqisave;

4 Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997). Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendër: fëmijët 3-5 vjeçarë. Washington D.C.: Organizata Ndërkombëtare për Burimet e Fëmijëve

- Komunikimi, gjuha dhe shkrim-leximi;
- Numërimi dhe aritmetika;
- Aspektet kulturore të jetës
- Kreativiteti⁵

Kështu tek fëmija ruhet natyrshmëria në ofrimin e materialeve, e poashtu i sigurohet fëmijës një rend logjikë sipas së cilit fëmija e ka më të lehtë të pavarësohet dhe të veprojë i pavarur në një mjedis i cili është mirë i organizuar. Çdo material i cili i ofrohet fëmijës duhet të jetë kuptimplotë, i qëllimshëm dhe të ketë një vend të caktuar në klasë. Fëmija përzgjedh materialin për punë, përzgjedh hapësirën ku dëshiron të luaj/punoj, në tapet, në tavolinë, në hapësirën e jashtme.

Nëse institucioni punon me **qasjen Reggio Emilia**⁶ organizimi i hapësirës së brendshme të dhomës mund të jetë i organizuar sipas këtyre qendrave:

- Ateliesë ose miniatelies
- Qendra e konstruktimit
- Qendra e mesazheve
- Qendra e matematikës
- Qendra e eksperimentimeve me dritë-hije

Në qasjen Reggjo Emilia mjedisi ndryshon në vazhdimësi duke krijuar kontekste të reja të cilat kanë për qëllim të provokojnë kureshtjen e fëmijëve ose janë reflektim i vëzhgimeve që ka bërë edukatori/ja mbi interesat e fëmijës. P.sh. nëse një fëmijë është pickuar nga blea dhe kjo ka ngjallur kureshtjen e grupit, nga këtu mund të lindin shumë pyetje si: Pse pickon blea? Si krijohet mjalti? etj. Kështu, edukatorja krijon një kontekst të ri brenda dhomës duke sjellë një libër që flet për jetën e bletëve, disa mjete të punës së bletarisë, çdo element që ajo mund të konsiderojë që i shtynë fëmijët drejt kësaj fushe të re njohese duke i nxitur fëmijët të bëjnë pyetje dhe të hulumtojnë për përgjigjet.

Në vendin tonë, institucionet e EFH-së dhe KP-të i përdorin metodologjitë e lartëpërmendura dhe të tjera të kombinuara me njëra-tjetërën. Në këtë rast duhet të jemi shumë të kujdesshëm që pavarësisht kombinimit që mund të bëjmë në organizimin e mjedisit

gjithmonë filozofia jonë e punës duhet të jetë me **fëmijën në qendër**.

Në këtë udhëzues janë prezentuar vetëm disa nga qendrat të cilat mund të konsiderohen të **domosdoshme ose esenciale** në ndërkohe së secili institucion parashkollor brenda dhomave/klasave mund të zgjerojë numrin e qendrave që ofrohen në atë mjedis duke marrë në konsideratë potencialet dhe nevojat e fëmijëve, gjithëpërfshirjen, metodologjisë me të cilën punon dhe gjithashtu hapësirën që ajo dhomë/klasë ka në dispozicion.

Qendra e gjuhës

Këndi i gjuhës është një nga këndet i cili ka për qëllim të ndihmojë fëmijët në zhvillimin gjuhësor dhe atë social por jo vetëm. Qendra e gjuhës përbëhet nga dy pjesë të cilat janë të integruara me njëra-tjetërën. Hapësira e leximit përbëhet nga një hapësirë ku ka të vendosur shumë jastëk të butë dhe një raftë me libra, ku fëmijët mund të ulen, shtrihen dhe shfletojnë librat. Zakonisht kjo qendër vendoset në pjesën më të qetë të dhomës. Ndërsa pjesa tjetërt e qendrës përmban materiale përmes së cilave nxitet zhvillimi dhe përdorimi i gjuhës së shkruar. Qendra mund të përmbajë edhe një mur të fjalëve ku fëmijët vendosin fjalët e reja që kanë mësuar. Organizimi i kësaj qendre pasqyron edhe strategjitë e punës së edukatorët përdorin për të nxitur përdorimin e shkrimit si psh. dekorimi i emrit të fëmijëve nga vet ata, shkrimi i emrit, dhurimi i kartolinave, shkrimi i fjalëve për kërkimet që bëjnë, etj.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Libra me tematikë nga bota e fëmijëve por edhe libra të ndryshëm enciklopedik
- Fletë të madhësive dhe ngjyrave të ndryshme (shih listën në fund të manualit)
- Lapsa
- Ngjyra
- Revista
- Materiale përmes së cilave praktikohet shkrimi

5 Isaacs, B. (2014). Bringing the Montessori approach to your early years practice. Routledge.

6 Edwards, C., Gandini, L., & Forman, G., (2012). The hundred languages of children: the Reggio Emilia Experience in transformation. Third editions. Praeger.

- Lojra të ndryshme (p.sh. lojëra me karta, bashkimi i figurës me grafikun e shkronjës, etj.)
- Materiale të ndryshme që mund të përdoren për modelimin e shkronjave, etj.



Fotografia 22.
Qendra e gjuhës me materiale të riciklueshme për grupmoshat 4-5 vjeç, IP Zambaku, Prizren.
© UNICEF/2024



Fotografia 23.
Qendra e gjuhës zhvilluar me materiale të riciklueshme dhe me dritë të butë. IP Ardhmëria Jonë, Ferizaj.

Qendra e matematikës

Përveç faktit që konceptet matematikore shtrihen përgjatë veprimtarisë tërë-ditore që fëmija realizon, qendra e matematikës ka përqëllim që të nxis të menduarit matematikorë përmes aktiviteteve dhe materialeve që ofrohen në këtë qendër. Në fëmijëri të hershme matematika më së miri kuptohet në veprimtari të drejtëpërdrejtë dhe kuptimplotë për fëmijën. Fëmijët e kësaj moshe nuk mund të mendojnë në mënyrë abstrakte prandaj konkretizimi dhe

materialet për konkretizimin e veprimeve janë shumë të rëndësishme në institucionet e EFH-së dhe KP-të. Klasifikimi dhe organizimi i mirë i materialeve është parakushti kryesor që e tërheq fëmijën drejt lojës në këtë qendër. Kur secili material ka vendin e tij dhe ofrohet në mënyrë të organizuar fëmijët ndjehen të gatshëm për të provuar sfidën e një loje sajuese, bashkimit të grafikut të numrit me sasinë e tij, lojën ku duhet të ndiqet modeli i dhënë, etj.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Mjete të natyrës si: guralec, boqa pishe, shkopinjë druri.
- Modele me numra dhe petëza druri
- Forma gjeometrike nga druri
- Trupa gjeometrik
- Materiale përmes së cilave mund të ekperimentohet me matjet,
- Grafike të numrave dhe materiale për krijimin e sasisë së numrit
- Materiale, mjete për krahasim
- Orë dhe mjete përcjellëse për matjen e kohës
- Rebuse
- Tabela me kinja
- Domino
- Lojëra me memorie
- Rruza me ngjyra
- Monedha
- Letër
- Lapsa
- Ngjyra



Fotografia 24.
Qendra e matematikës tek grupmoshat 4-5 vjeç, IP Ardhmëria Jonë, Ferizaj.
© UNICEF/2024



Fotografia 25.
Qendra e matematikës formuluar me materiale të ricikluar, IP
Ardhmëria Jonë, Ferizaj.
© UNICEF/2024

Qendra e konstruktimit

Konstruktimi është veprimtari e natyrshme e fëmijës e cila është ngushtë e lidhur me lojën që fëmija bën. Konstruktimi me blloqe druri ka një rëndësi të madhe në zhvillimin e fëmijës në shumë drejtime, duke përfshirë aspektin gjuhësor, shprehitë shoqërore, zhvillimin e aftësive motorike, të menduarit matematikor dhe atij shkencor.⁷ Puna me blloqe i lejon fëmijët të eksperimentojnë dhe provojnë forma të ndryshme të konstruktimit pasi nuk ka një rrugë të vetme e cila duhet të ndiqet.

Në lojën me blloqe fëmija është i lirë të përdor imagjinatën e tij si gjatë ndërtimit ashtu edhe gjatë lojës. Kur lojën me blloqe e shoqërojmë edhe me lodra të tjera mbështetëse atëherë kjo lejon fëmijën që të zgjerojë edhe më tepër mundësitë për lojë. Kur loja luhet në grup, fëmijët provojnë një varg shkathëtisish të cilat kanë të bëjnë me negociimin, pranimin e ideve, dëgjimin aktiv, marrjen e vendimeve, kështu fëmijët mësojnë duke praktikuar një varg shkathëtisish jetësore të cilat zhvillohen shumë natyrshëm përmes lojës.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Blloqe druri për konstruktiv të madhësive dhe formave të ndryshme.
- Figura të njerëzve nga druri i pangjyrosur
- Figura të kafshëve nga druri i pangjyrosur
- Makina të vogla, kamion dhe mjete të tjera nga druri
- Shenja të komunikacionit
- Mobilje shtëpiake (tavolina, karriga, dollapa, etj.) nga druri i pangjyrosur



Fotografia 26.
Hapësira e konstruktimit e zhvilluar nga materiale të ricikluar, IP
Ardhmëria Jonë, Ferizaj.
© UNICEF/2024

Qendra e shkencës

Pyetjet si Pse? Si? Çfarë? e shoqërojnë fëmijën përgjatë gjithë periudhës së fëmijërisë së hershme. Përgjatë eksplorimeve mbi fenomenet e ndryshme, fëmijët do të vrojtojnë, ngrisin hipoteza, mbledhin të dhëna përmes shënimeve, vizatimeve, fotografive për të dokumentuar fenomenin që po ndodh. Prandaj, edukatorët duhet të ofrojnë ndihmën e duhur për fëmijët përmes përgatitjes së mjedisit, sigurimit të mjeteve dhe materialeve për të cilat fëmijët kanë nevojë për tu zhytur në botën e kërkimit. Kështu fëmija gjatë këtij kërkimi ndërlidh të gjitha njohuritë që ajo ka; ajo përdorë shkrimin, vizatimin, aparatën fotografik, kërkon të dhëna, organizon të dhënat së bashku me bashkëmoshatarët e tij/saj, përfshinë pjesëtarët nga familja, e përmes vizitave përfshihen edhe pjesëtarët nga komuniteti.

Qendra e shkencës në vazhdimësi ndryshon për nga përbërja e materialeve pasi ajo duhet t'i përgjegjet asaj që është aktuale në jetën e fëmijës.

Mos ju ofroni fëmijëve përgjigje të gatshme, por ndihmoni ata të gjejnë vetë përgjigjet për pyetjen e ngritur përmes kërkimit, vëzhgimit, dhe hulumtimit të dukurisë. P.sh. Nëse një fëmijë pyet se: Përse farat e fruteve nuk janë të gjitha njëloj, kur të gjitha janë fryte që rriten në pemë? Ky është një moment kyq për ta përfshirë grupin dhe për të gjetur rrugën sesi mund ta hulumtojmë këtë dukuri duke filluar që nga ndërtimi i pyetjes, vërtetimi i dukurisë, mbledhja e të dhënave dhe arritja në përfundime.

7 Coughlin, P. A., Hansen, K. A., Heller, D., Kaufmann, R. K., Stolberg, J. R., & Walsh, K. B. (1997). Hap pas Hapi: Një program për fëmijët dhe familjet: Krijimi i klasave me fëmijët në epiqendrë: fëmijët 3-5 vjeçarë. Washington D.C.: Organizata Ndërkombëtare për Burimet e Fëmijëve

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Libra dhe enciklopedi me fenomene nga natyra
- Tavolina me dritë
- Mikroskopi elektronik (i cili mund të lidhet me lap-top, ose kompjuter)
- Bimë të gjalla
- Magnete
- Llupa zmadhuese
- Materiale të natyrës (gurë, minerale, guaca, gjethe, bimë të gjalla, fara, etj)
- Gozhda, Çekan,
- Vida dhe kaçavida
- Termometri
- Enë për kapjen e insekteve
- Pinca
- Pikatorja
- Materiale ushqimore si: krip, sodë buke, uthull, vaj, sheqer
- Dhe materiale të tjera në varësi të tematikave.



Fotografia 27.
Eksplorimi i materialeve te natyres me tavolinë të dritës, SHFMU
Bahtri Kuqi, Shtitarice



Fotografia 28. Hulumtimi i ushqimit me mikroskop,
IP Botanika, Prishtine

Qendra e dramatizimit

Qendra e dramatizimit është qendra në të cilën në vazhdimësi edukatorët duhet të ndryshojnë materialet që ofrohen. Sistemimi i materialeve nëpër kuti tematike i lejon edukatorët që në vazhdimësi të pasurojnë qendrën me materialet e nevojshme për tematikën aktuale. Kjo qendër në varësi të tematikës mund të transformohet nga një teatër në një dyqan/treg, apo nga një stacion veterinar në një qendër hapësinore. Transformimi i kësaj qendre në varësi të interesave të fëmijëve dhe tematikës aktuale ndihmon që ajo çfarë fëmijët bëjnë të jetë në harmoni me interesat që ai/ajo ka.

Çfarë është kutia tematike?

Kutia tematike është një set i materialeve që i përgjigjen një teme të caktuar dhe që nuk mund të përdoren përgjatë tërë vitit. Një kuti tematike me temë Vjeshtën mund të përmbajë: lojëra me memorie me temë vjeshte, karta për numërim me simbolet e vjeshtës, karta për zhvillimin e gjuhës me fjalët karakteristike të vjeshtës, apo libra që trajtojnë temat nga vjeshta. Cikli i rritjes së kungjullit mund të përmbajë karta, lodra, mjete mbështetëse, pëlhura të mëdha me ngjyrat e vjeshtës, veshje karakteristike të vjeshtës, mantel shiu, kapele shiu, çadër, apo çdo material tjetër që mund të përdoret gjatë kësaj tematike.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

Veshje dhe mjete sipas tematikave të ndryshme si:

- uniforma dhe mjete të mjekut,
- zjarrëfiks,
- polic,
- kuzhinier,
- astronaut,
- ushtar,
- balerin,
- rekuizita të sporteve të ndryshme
- instrumente muzikore.

Kërkoni ndihëm e familjes për të siguruar materiale si:

- Çanta
- Këpucë
- Kapele
- Veshje të ndryshme
- Paruke
- Hekur për hekurojse
- Piktura të ndryshme
- Libra
- Tastier kompjuteri
- Letra mbështjellëse
- Syze
- Vegla pune të ndryshme
- Doreza
- Enë kuzhine dhe pajisje të tjera...



Fotografia 29.

Këndi i dramës në klasë parafillore (5 vjeç) në objekt të shkollës, Shfmu - "Bahri Kuqi" Shtitaricë.
© UNICEF/2024.



Fotografia 30.

Këndi i dramës në IP. C.Fabbi/2023.

Qendra e rërës dhe ujit

Kjo qendër mund të jetë e vendosur në hapësirat e brendshme dhe atë të jashtme të institucioneve të EFH-së dhe KP-të. Gjatë punës në këtë qendër fëmijët mund të eksperimentojnë dhe të zhvillojnë njohjen duke përdorur sa më shumë shqisa. Mbushja, zbrazja e ujit nga enët, zhytja e gjërave krijojnë

mundësi të reja njohëse. Eksperimentimi me materiale të ndryshme krijojnë gjithmonë mundësi të reja njohëse.

Kjo qendër vendoset në një hapësirë ku fëmijët mund të komunikojnë me zë të lartë dhe mirëmbajtja e hapësirës përrreth është lehtë e mundshme. Fëmijët me udhëzimet dhe ndihmën e edukatorës mund të kujdesen pjesërisht vet për mirëmbajtjen e kësaj qendre.

Materialet që mund të përmbajë kjo qendër mund të jenë të ndryshme dhe varen shumë edhe nga tematikat të cilat janë në interes të fëmijës.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Menzura të madhësive të ndryshme
- Sfungjer
- Lodra të vogla
- Hinka
- Enë të thella
- Pikatore
- Dhe elemente të tjera të cilat shtohen në vazhdimësi (gjethe, boqa pishe, kube akulli, etj.)
- Set i lodrave të plazhit



Fotografia 31.

Qendra e rërës në hapësirë të jashtëm të me mbrotjtje IP Shkronjat, Prishtinë
©UNICEF/2024.



Fotografia 32.

Qendra e rërës në hapësirë të jashtëm IP Botanika, Prishtinë .



Fotografia 33.
Fëmijet duke eksploruar një plastikë me ujë,
Qerdhja Ardhmenia -Prishtine (106)
© UNICEF

Në pamundësi që në dhomat tuaja të keni një qendër të tillë:

Alternativa 1: Praktikoni që gjatë javës të mbushni një plastikë të madhe me ujë, të ofroni disa mjete të ndryshme për lojë dhe të lejoni fëmijët të eksplorojnë përmes lojës me ujin.

Alternativa 2: Në pamundësi që të përdorni ujin merrni një plastikë të madhe hidhni oriz dhe ofroni mjete dhe materiale me të cilat mund të mbush, zbrazë, hamendësojë për peshën dhe zgjerojë lojën sipas imagjinatës së tij/saj.



Fotografia 34.
Fëmijet duke eksploruar plastikën me oriz dhe me
materialet të ndryshme IP Ardhmeria Jone,Ferizaj
©UNICEF/2024

Qendra e artit


Qendra e artit mund të konsiderohet si një ndërhapësirat e cila në mënyrë të natyrshme ndërvepron me të gjitha qendrat tjera përmes përdorimit të 100 gjuhëve të fëmijës. Nuk ekziston një formë e vetme shprehëse e cila mund t'i përgjigjet të gjithë fëmijëve prandaj është shumë e rëndësishme që përmes mjeteve dhe materialeve në qendrën e artit fëmijët të gjejnë shkëndijën e tyre.

Përgatitja dhe ofrimi i materialeve në qendër ka shumë rëndësi në mënyrën sesi fëmijët zgjedhin të përdorin artin. Sa më të larmishme që janë mundësitë e shprehjes artistike aq më të mëdha janë mundësitë e fëmijës për të njohur dhe zbuluar shkathtësitë që ai/ajo ka përbrenda. Ofrimi i modeleve pengon zhvillimin e lirë të shprehjes artistike prandaj detyrë e edukatorit është që të sigurojë një mjedis ku fëmija mund të shprehet lirshëm bazuar në aftësitë që ai/ajo ka.

Ofrimi i fletëzave të gatshme për ngjyrosje nuk është mënyra e duhur për të nxitur shprehjen e lirë të fëmijës dhe zhvillimin e saj artistik. Prandaj zëvendësoni fletëzat e printuara duke u kujdesur që të përgatitni mjedisin (Shih Krijimi i konteksteve për të nxënësit) në atë mënyrë që fëmijët të zhvillojnë të lirë shprehjen përmes përdorimit të artit.

Një listë **materialeve të mundshme** mund të jenë:

- Letra të madhësive dhe sipërfaqeve shqisore të ndryshme
- Lapsa të trashësive të ndryshme
- Ngjyra druri,
- Ngjyra dylli
- Tempero
- Brusha
- Sfungjer të vegjël
- Pulla
- Materiale dekorative
- Ngjitës
- Gërshër
- Plastelinë
- Argjilë
- Mjete për përpunimin e argjilës
- Shtrojë silikoni për punë me plastelinë ose argjilë, etj.



Fotografia 35.
Hapësira e artit në korridor të qasshëm për të gjithë grupet IP
Shkronjat, Prishtinë ©
UNICEF/2024.

Mini-atelieja

Dhomat mund të kenë në një pjesë të saj edhe mini-atelienë, hapësirë kjo e cila i dedikohet zhvillimit të aktiviteteve nga fusha e artit, punës me argjilë dhe materialeve të tjera të cilat kërkojnë një hapësirë punuese më të qetë dhe më të thelluar në punë të pavarur. Këtu fëmijët punojnë për periodha më të gjata kohore, vetëm ose në bashkëpunim me bashkëmoshatarët në varësi të punës që ata po bëjnë. Këtu gjejnë një numër të madh materialeve të cilat janë të sistemuara dhe të ndara në atë mënyrë që t'i lejojë fëmijës të eksplorojë secilin material në veçanti dhe t'i kombinojë ato së bashku për të krijuar diçka të re. Në institucionet që punojnë inspiruar sipas qasjes Reggio Emilia mini-atelieja gjendet tek secila dhomë tek grupet edukative 3-6 vjeç.



Fotografia 36.
Materialet të sistemuara në mini atelie mbrenda grupit IP
Zambaku, Prizren
© UNICEF/2024.

Hapësira e lirë për takimet e përbashkëta brenda dhomës/klasës

Brenda dhomës së punës/klasës duhet të ekzistojë një hapësirë e lirë ku edukatori/ja ka mundësi të krijojë takime të përbashkëta me tërë grupin prej nga edhe fillon tërë veprimtaria e një dite. Ndjekja e një rutine ditore (takimi i përbashkët, puna në qendra,

koha në natyrë, takimi përmbyllës) i ndihmon fëmijët të përshtaten më mirë në institucionet e EFH-së dhe KP-të por përmbajtja e pjesëve të rutinës ditore, si loja që zhvillohet në takim, hyrja në tematikën ditore, etj., duhet të jenë të larmishme. Kjo gjë i mban fëmijët të entuziazmuar për takimin sepse ata tashmë e dijnë që një gjë e mirë po i pret.



Fotografia 37.
Fëmijet përfshirë në diskutimi i përbashkët mbrenda grupit IP
Shkronjat, Prishtinë
© UNICEF/2024/S.Karahoda.

ATELIEJA

E ngjashme me mini-atelien më lartë, atelieja është hapësirë e cila përdoret nga të gjitha grupet edukative, dhe jo vetëm një grup brenda një klase të veçantë. Kjo hapësirë i dedikohet lirisë së shprehjeve artistike ku gjuhët shprehëse të fëmijës nuk kanë kufizime. Në hapësirën e atelies eksperimentohet me materiale nga më të ndryshmet përmes së cilave fëmijët kanë mundësi të testojnë, provojnë, bëjnë pyetje, eksperimentojnë përmes përdorimit të veglave të ndryshme, formave dhe teknikave të ndryshme të shprehjeve, ku fëmijët janë të lirë të zbulojnë mënyrën e tyre të menduarit, zhvillojnë kreativitetin dhe imagjinatën, japin idetë dhe praktikojnë ato, testojnë hipoteza dhe provojnë teknika të ndryshme të punës me materiale të njëjta apo të ndryshme.

Në atelie fëmija zhvillon mënyrën e saj të pavarur të menduarit drejtë arrijtes së një qëllimi apo zgjidhjes së një problemi. Fëmija mund të punojë i pavarur ose në bashkëpunim me të tjerët, mund të punojnë rreth një fenomeni që i intereson vetëm atij/asaj apo një grupi të vogël të fëmijëve. Atelieristja/ti, që në mungesë të stafit përkatës mund të jetë edukatorja e shkathtësuar mbi atelien, është në rolin e fasilitueses, e cila vëzhgon, mban shënime, koleksionon të dhëna për të qenë në gjendje të krijoj një mjedis që të ndihmojë

fëmijën të zhvillojë të nxëniet e tij/saj në një hap tutje. Poashtu ajo ofron mjetet, materialet dhe instrumentet që mund të ndihmojnë fëmijën në eksplorimet e mëtejme, dhe poashtu të ndihmojë edukatorët në krijimin e konteksteve të të nxëniet.



Fotografia 38.
Atelie e brendshme në korridoret të IP-së të qasshme nga gjithë grupet
IP Botanika, Prishtinë.

Materialet që mund të përmbajë atelieja mund të jenë të ndryshme dhe varen shumë nga konteksti ku ajo është e vendosur dhe tematikat të cilat janë në interes të fëmijës, kuptuar nga vëzhgimet e bëra.

Një listë **materialesh të mundshme** mund të jenë:

- Bimë të gjalla të vendosura në enë qelqi
- Argjilë dhe mjete për përpunimin e argjilës
- Kavaletë dhe mjete për pikturim/vizatim
- Lapsa grafiti të trashësive të ndryshme
- Letra të teksturave të ndryshme
- Mjete dhe materiale të natyrës si: (guralec, gurë kristalor, boqa pishe, stika pishe, guaska, bimë të ndryshme etj).
- Mjete dhe materiale të ripërdorshme nga tekstili, kartoni, letra, plastika, etj.
- Mjete dhe materiale që ndihmojnë për eksplorim të mëtejshëm: llupa zmadhuese, pikatore, enë mbajtëse, ujë, pasqyra, vegla pune, mikroskop, laptop, etj.
- Libra enciklopedik, etj.

Sistemi dhe rregullimi i materialeve duhet të bëhet në mënyrë harmonike duke ofruar një mjedis i cili provokon fëmijën dhe nxitë eksplorimin e tij të pavarur me mjetet dhe materialet që i ofrohen.



Fotografia 39.
Materialet e sistemuara në lartësinë e fëmijëve që lejon eksplorimin IP
Zambaku, Prizren
©UNICEF/2024.

BIBLIOTEKA

Është hapësira e cila shfrytëzohet nga fëmijët, edukatorët, prindërit dhe të tjerët për shumë qëllime duke filluar që nga kërkimet e thjeshta për ndonjë libër e deri tek takimet e përbashkëta për të hulumtuar më tej mbi një temë të caktuar. Nëse hapësira në institucion nuk është e mjaftueshme biblioteka dhe dhoma e takimeve mund të vendosen brenda një hapësire.

Biblioteka duhet të pasurohet në vazhdimësi me tituj të rinjë si të librave për të rriturit ashtu edhe me libra për fëmijë në mënyrë që të jetë gjithmonë në linjë me nevojat e prindërve dhe edukatoreve për të kërkuar për tema dhe aktivitetet të reja. Ka mënyra të ndryshme përmes së cilave mund të bëjmë këtë: bashkëpunimi me organizatatat e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore, kërkimi për donacione, dhurimi i librave nga prindërit fëmijët e të cilëve tashmë janë rritur, organizimi i klubeve të leximit brenda institucioneve, etj.




Fotografia 40.
Biblioteka në korridor të qasshme për të gjithë grupet
IP Ardhmëria Jone, Ferizaj
©UNICEF/2024.

DHOMA E TAKIMEVE

Është hapësirë e dedikuar për bashkëpunimin ndërkolegial dhe takimet brenda stafit pedagogjik të cilët janë pjesë përbërëse e veprimtarisë që zhvillohet në institucion. Dokumentimi i punës, diskutimi në mes të kolegëve, propozimet, idetë nga fëmijët edhe shumë elemente të tjera kërkojnë kohë për reflektim, prandaj një hapësirë e tillë krijon mundësinë që këto takime të zhvillohen në mënyrë të rregullt. Këto hapësira shërbejnë edhe për bashkëpunimin dhe ndërveprimin me prindërit dhe pjesëtarët e tjerë nga komuniteti. Kjo hapësirë mund të shërbejë edhe si një hapësirë për kalimin e kohës së pushimit të edukatorëve.

Kjo hapësirë duhet të jetë e pajisur me kompjuter, printer, fotokopje, skaner, plastifikues dhe pajisje të tjera të cilat i lehtësojnë punën e edukatorëve/it dhe shërbimeve profesionale, si në krijimin e materialeve didaktike, në planifikimin dhe organizimin e punës, regjistrimin e vëzhgimeve të bëra, etj.



Fotografia 41.
Korridoret e zyreve të IP-së me mjetet e nevojshme për përdorim IP
Zambaku, Prizren
©UNICEF/2024.



Fotografia 42.
Dhoma e takimeve pas prezantimit i projektit të ri të kopshtit "Ferma e kopshtit" IP Zambaku, Prizren
©UNICEF/2024.



Fotografia 43.
Dhoma e takimeve në korridor të IP-së, IP Yllkat, Prishtinë
©UNICEF/2024.

KUZHINA

Përveç përgatitjes së ushqimit dhe shërbimit të saj, kuzhina mund të kuptohet edhe si një hapësirë e përbashkët ku ndodh edukimi mbi ushqimin. Shumë aktivitete të përbashkëta mund të zhvillohen duke përfshirë kuzhinierët, ushqimin, përgatitjen dhe transformimin e ushqimit. Ushqimi është një element i rëndësishëm për mirërritjen e fëmijës dhe krijimin e shprehive të shëndetshme për jetë. Prandaj, përdorimi i kuzhinës, përgatitja e ushqimit, eksperimentimi me ushqimet dhe testimi i shijeve të ndryshme duhet të jetë pjesë përbërëse e veprimtarive që zhvillohen në institucion e EFH-së.

Një element tjetër me rëndësi është marrja e përgjegjësisë nga fëmijët në baza ditore mbi servimin dhe përgatitjen e tavolinës për kohën e ngrënjes. Të ushqyerit në hapësira të përbashkëta në mes të grupeve apo edhe të ushqyerit në grupe më të vogla brenda dhomave të punës duhet të kuptohet si një ritual i cili është i ndërlidhur me jetesën e përbashkët dhe ndarjen e përgjegjësisë.



Fotografia 44.
Përfshirja e fëmijëve në aktivitetet e kuzhines IPSHkronjat, Prishtinë
©UNICEF/2024/S. Karahoda

Në klasat parafillore të cilat gjenden në kuadër të shkollave fillore, ku kuzhinat mungojnë, edukatorët përmes projekteve të ndryshme mund të transformojnë mjedisin

dhe të gatuajnë dhe eksperimentojnë me ushqimin së bashku me fëmijët bazuar në interesat që ata kanë. Përfshirja e familjes dhe komuniteti në aktivitetet e përbashkëta, organizimi i vizitave mund ta zgjojë kureshtjen e fëmijëve për të eksploruar më tepër rreth ushqimit, gatimit, përbërësve, etj.



Fotografia 45.
Fëmija në vizita në treg për të blerë pemë dhe perime. IP Dayschool, Prishtinë.

DEPO E MATERIALEVE

Organizimi dhe sistemimi i materialeve në një hapësirë të veçantë krijon mundësi që dhomat e punës/klasat të mos mbingarkohen me materiale të cilat nuk korespondojnë me aktualitetin e projekteve që zhvillohen në atë periudhë kohore. Poashtu mund të shërbejë për të gjithë sistemimin e materialeve të ripërdorshme që mund të sillen në institucion e EFH-së apo në KP nga prindërit dhe vullnetarë të ndryshëm. Depoja me materiale ofron mundësi që edukatorët bashkë me stafin mbështetës dhe atelieisten të mendojnë se cilat do të ishin materialet më të përshtatshme për t'ia ofruar fëmijës në një kohë të caktuar.

Kjo hapësirë mund të shërbejë si një thesar materiale për të mund të ofrohen në varësi të interesave të fëmijëve përgjatë projekteve. Krijimi i konteksteve të të nxëniet ka nevojë për materiale të cilat nxisin interesin e fëmijës për të hulumtuar tutje mbi subjektin ose dukurinë. Është shumë me rëndësi që materialet brenda kësaj depeje të jenë të sistemuara dhe të klasifikuara në mënyrë që ato të mund të përdoren përgjatë temave të ndryshme. Poashtu këtu mund të vendosen edhe kutit tematike me materialet të cilat krijohen përgjatë temave nga edukatorët e institucionit.

ORGANIZIMI I MJEDISIT TË JASHTËM


Hapësira e jashtme e institucioneve të EFH-së kuptohet si një hapësirë e zgjeruar e hapësirave të brendshme dhe përdorimi i saj është i shumëfishtë. Edhe mjedisi i jashtëm ashtu sikurse mjedisi i brendshëm është në funksion të nxitjes së fëmijës dhe zhvillimin e aftësive të tij kognitive, afektive e psikomotorike. Ai mund të ndryshojë dhe transformohet sipas nevojave të fëmijëve, dhe shumë veprimtari të cilat mund të krijohen në hapësirat e brendshme në kohë të caktuara zhvendosen edhe në hapësirat e jashtme të institucionit.

Në varësi të projektit që fëmijët bëjnë, mjedisi i të nxënit zhvendoset edhe në hapësirën përtej institucionit, duke i dërguar fëmijët në hapësirat përkatëse që ata të marrin të dhëna përmes burimeve të drejtpërdrejta të njohjes, si për shembull vizita në institucione shëndetësore, tregun e gjelbërt, teatër, etj. Fëmijët vendosen në situata hulumtuese duke mbledhur të dhëna për çështjen që po trajtojnë dhe më pas me të dhënat e mbledhura vazhdojnë punën e tyre në institucion të EFH-së ose KP. Kështu fëmijët janë pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e të nxënit të tyre.

Edhe mjedisi i jashtëm duhet të jetë i qashtëm dhe gjithëpërfshirë për fëmijët me aftësi të kufizuara të ndryshme, dhe i ndarë në disa zona në varësi të veprimtarive që zhvillohen me qëllim që fëmijët përgjatë lojës të mos pengojnë veprimtarinë e njëri-tjetrit. Hapësirat mund të jenë të ndara edhe me litar deri sa fëmijët të kuptojnë se cilat janë zonat nga mund të kalohet dhe cilat janë zonat ku pengohet loja e të tjerëve dhe aksidentalisht mund të lëndohemi.



Fotografia 47. Hapësira e lojës në oborrin e institucionit. IP Ardhmëria Jonë, Ferizaj. © UNICEF/2024



Fotografia 48. Hapësira e lojës në oborrin të institucionit, IP Shkronjat, Prishtinë. © UNICEF/2024

Për fëmijët deri në dy vjeç, dhe dy – tre vjeç duhet të jetë një hapësirë e ndarë, ku fëmijët që zvarriten nuk rrezikohen nga fëmijët të cilët vrapojnë. Hapësira duhet të jetë e pajisur me lodra dhe mjete të cilat i përgjigjen nevojave të kësaj moshe.

Për fëmijët mbi tre vjeç duhet të jetë një hapësirë e ndarë, në mënyrë që fëmijët të mund të lëvizin lirshëm nëpër hapësirat e lojës. Hapësira duhet të jetë e pajisur me lodra dhe mjete të cilat i përgjigjen nevojave të kësaj moshe.

Siguria e fëmijëve për të gjitha grup-moshat është elementi kyesor i cili merret për bazë. Edukatorët gjithmonë duhet të kujdesen që të bëjnë një vëzhgim mbi gjendjen e lodrave në mënyrë që të sigurohen që ato janë në gjendje të rregullt. Lodrat duhet të inspektohen në mënyrë të vazhdueshme nga personat përgjegjës për kontrollim⁸.

Ndër hapësirat, lodrat dhe paisjet e mundshme për fëmijët deri në tre vjeç mund të jenë⁹:

Hapësirë e mbuluar me material të butë për lojë: Këto ofrojnë një sipërfaqe të sigurt për zvarritje, ulje dhe lojë. Ato janë veçanërisht të dobishme për fëmijët që ende nuk kanë mësuar të ecin.

Tavolina lojërash me rërë dhe ujë: Këto qendra lojërash sensorike i lejojnë fëmijët të eksplorojnë tekstura të ndryshme dhe të mësojnë rreth shkakut dhe pasojës. Staf i edukativ duhet të sigurohet se ato të jenë të përshtatshme për moshën dhe kanë skaje të rrumbullakosura.

8 [Play Australia. \(n.d.\). PLANNING FOR SAFE OUTDOOR PLAY IN CHILDREN'S SERVICES. In https://www.playaustralia.org.au/sites/default/files/LibraryDownloads/Planning%20for%20Safe%20Outdoor%20Play%20in%20Childrens%20Services.pdf](https://www.playaustralia.org.au/sites/default/files/LibraryDownloads/Planning%20for%20Safe%20Outdoor%20Play%20in%20Childrens%20Services.pdf).

9 Pardee, M. P., Gillman, A. G., & Larson, C. L. (2005, June). Creating Playground for Early Childhood Facilities. Community Investment Collaborative for Kids. https://www.lisc.org/media/filer_public/c6/c8/c6c8b045-d3c9-46ad-ab6d-65d6b807a666/2005_click_guide_vol4_playgrounds.pdf

Luhatëse për fëmijë: Pajisje me lëkundje të stilit kovë me rripa sigurie. Këto janë të dizajnuara për fëmijët deri në dy vjeç dhe ofrojnë një përvojë të butë lëkundjeje.

Strukturat e ngjitjes: Korniza të thjeshta ngjitjeje ose platforma të ulëta me rampa dhe shkallë mund të inkurajojnë zhvillimin e aftësive motorike bazike.

Tunelet dhe hapësirat e zvarritjes: Tunelet e buta ose strukturat e zvarritura prej pëlhere janë të shkëlqyera për eksplorim dhe ndërgjegjësim hapësinor.

Lodrat me kalim: Makinat e vogla, triçikletë ose lodra me shtytje ndihmojnë me ekuilibrin dhe koordinimin.

Zona e eksplorimit të natyrës: Përfshi elemente natyrore si trungje, shkëmbinj dhe bimë. Fëmijët deri në dy vjeç mund të prekin, eksplorojnë dhe mësojnë rreth natyrës.

Edhe për fëmijët e moshave nga tre deri në gjashtë (3-6_ **vjeç mjedisi i jashtëm duhet të jetë i shfrytëzuar në baza ditore** dhe të ofrojë mundësi të reja eksploruese për fëmijët. **Shumë nga qendrat nga hapësirat e brendshme mund të barten në hapësirat jashtë.** Ndër to mund të përmendim qendrën e artit, qendrën e kuzhinës, qendrën e muzikës, qendrën e konstruktimit, qendrën e shkencës, etj.

- Hapësira për lojërat me biçikleta, triçikleta, lojrat me top, sportet etj.
- Hapësira për lojëra që përfshijnë paisjet për ngjitje, rreshqitëset, kolovajzat dhe
- Hapësira e rërës dhe ujit
- Ngrenia në natyrë
- Kopshtaria



Fotografia 49.
Aktivitetet në hapësirë të jashtëm fëmijët duke vizatuar diellin. IP Archmeria Jone, Ferizaj
© UNICEF/2024



ORGANIZIMI I MJEDISIT NË KLASAT PARAFILLORE

Organizimi i mjedisive në dhomat/klasat parafillore nuk duhet të dallojë shumë nga mjedisi i dhomave në institucione parashkollor, meqë grup-mosha është e njëjtë (5-6 vjeçar, në disa raste edhe 4-6 vjeç) fëmijët duhet tu ekspozohen mundësive të ngjashme zhvillimore. Pavarësisht faktit të në klasat parafillore koha e qëndrimit është me e shkurtër, fëmija përveç ritunave të gjumit dhe ushqimit, pjesën aktive të zhvillimit të aktiviteteve duhet ta ketë edhe në klasat parafillore.

ORGANIZIMI I MJEDISIT TË BRENDSHËM

Për organizimin e mjedisit në klasën parafillore (KP) ju mund të orientoheni tek pjesa e organizimit të mjedisit tek institucionet e EFH-së. Për të zëvendësuar kuzhinën dhe përdorimin e saj në klasat parafillore mund të shtohet edhe qendra e kuzhinës.



Fotografia 50.
Hapësira e kuzinës në klasën parafillore. Shfmu – “Bahri Kuqi”
Shtitaricë
© UNICEF/2024

Secila klasë parafillore në varësi të kontekstit ku ajo vepron dhe hapësirës që disponon ajo duhet organizojë mjedisin bazuar në kërkesat kurrikulare dhe interesat më të larta të fëmijëve.



Fotografia 51.
Hapësira me disa kënde në klasën parafillore. Shfmu – “Bahri Kuqi”
Shtitaricë
© UNICEF/2024

Klasat parafillore duhet të kenë brenda dhomave të punës një duarlarësë dhe një krua. Nëse kjo mungon atëherë edukatorja duhet të shfrytëzojë alternativën një dhe dy për qendrën e rërës dhe ujit. Edukatorët në bazë të vëzhgimit të nevojave të fëmijëve bëjnë edhe rregullimin e qendrave të aktiviteteve por mungesa e ujit brenda dhomës së punës nuk duhet të jetë shkaktari për të mos realizuar aktivitete të tilla. Në ditët e verës mjedisi i jashtëm është një alternative e mirë për këtë.



Fotografia 52.
Grup i parafillorëve nga një perspektivë më e gjere. Vushtri.
© UNICEF/2024

ORGANIZIMI I MJEDISIT TË JASHTËM

Shkollat fillore zakonisht kanë një hapësirë të madhe e cila vihet në përdorim nga nxënësit e gjithë shkollës. Krijoni mundësitë që klasa parafillore të ketë një pjesë të ndarë në oborrin e shkollës si një hapësirë e cila do të jetë në përdorim vetëm nga fëmijët parafillore. Ky ndryshim do të mundësonte që mjedisi i jashtëm në klasat parafillore të ngjasonte mjaft shumë me mjediset në institucionet e EFH-së dhe kështu fëmijët do të mund të krijonin më shumë eksperiencë në mjedisin e jashtëm. Duke shfrytëzuar materialet nga natyra ju mund të krijoni ide të reja të përdorimit të mjedisit në funksion të nevojave të fëmijëve.



Fotografia 53.
Mjedisi jashtëm në klasën parafillore - Shfmu - "Bahri Kuqi" Shtitaricë.

PËRDORIMI I HAPËSIRAVE TË PËRBASHKËTA KOMUNITARE

Zgjerimi i aktiviteteve të të nxënësve përtej mureve të institucionit të EFH-së dhe KP-së, është karakteristikë e një pune cilësore. Shfrytëzimi i hapësirave të përbashkëta komunitare është një mundësi e mirë edhe për krijimin edhe ofrimin e një perspektive të re për fëmijët por edhe të bërit publike puna që zhvillohet në Institucionet e EFH-së dhe KP-të. Kështu institucionet dhe shoqëria fillojnë dhe i rrëzojnë muret ndaj njëri-tjetrit. Shfrytëzimi i bibliotekave, muzeumeve, observatoriuimit, puna në shoqata të ndyrshme mund të jetë një pikënisje për afruar punën që zhvillohet në Institucione të EFH-së dhe KP me komunitetin.



Fotografia 54.
Vizita e komunitetit në institucionin parashkollor (Botanika, Prishtinë)

UDHËZIME PËR KRIJIMIN E MJEDISIVE MIQËSORE – ROLI I EDUKATORES

Mjedisi mund të ndikohet nga forma e hapësirave, organizimi funksional dhe tërësia e perceptimeve shqisore (si: drita, ngjyra, kushtet akustike dhe mikroklimatike, efektet prekëse). Preferencat në ngjyrë, prekje, erë dhe dritë ndryshojnë nga individ në individ dhe ndikohen fuqishëm nga dallimet në baza individuale, që nuk mund t'i atribuohen vlerave standarde të përbashkëta për të gjithë. Me fjalë të tjera, zgjidhjet standarde individuale nuk mund të jenë të pranueshme për gjithë¹⁰. Prandaj edukatore të bashku me personelin mbështetës brenda institucioneve të EFH-së dhe KP-të dhe prindërit janë gjithmonë në kërkim të ofrimit të një mjedisi i cili i përgjigjet nevojave të fëmijës.

Për ta arritur këtë kërkohet që mjedisi të jetë një vend i transformueshëm, i cili ndryshon dhe zhvillohet vazhdimisht në bazë të interesave të fëmijëve, dhe një vend harmonik ku takohen nevojat e grupit dhe priret individuale, ku edukatori/ja është reflektues/e dhe ofron atë që fëmijës i përgjigjet. Mjedisi nuk prezanton thjeshtë vetëm hapësirën por ai është shumë më tepër se atë. Mjedisi prezanton kompleksitetin e tërë raporteve, ndërveprimit me njëri-tjetrin, ndërveprimin me materialet etj. Me një fjalë, mjedisi është hapësira ku fëmija ndërton të nxënësin e tij.

¹⁰ Ceppi & Zinni (2008). Children, space, relations: metaproject for an environment for young children. Reggio Children: Domus Academy Research Center

Përmes vëzhgimit dhe regjistrimit të të dhënave, gjatë takimeve pedagogjike edukatorët kanë mundësi të diskutojnë së bashku dhe shpalosin vëzhgimet e bëra me qëllim që të kuptojnë nevojat, interesat dhe prirjet e fëmijëve. Përmes punës në bashkëveprim të edukatoreve mbi vëzhgimet e bëra ato krijojnë kontekste të të nxënës duke sjellë brenda klasës një objekt, mjet, fotografi, material i cili i shërben qëllimit të nxitjes së kureshtjes dhe provokimit të interesit të fëmijës. Kështu mjedisi shndërrohet në një vend dinamik ku ndryshimi është i vazhdueshëm dhe ndodh me qëllimin që t'i përgjigjet nevojave, prirjeve dhe potencialeve të fëmijëve.

“ Një mjedis i përditshëm në institucion parashkollor në mënyrë të vazhdueshme aktivizohet dhe modifikohet nga eksplorimi dhe hulumtimi i të gjithë protagonistëve si fëmijët, edukatorët dhe prindërit. Të cilët lënë gjurmët të tyre përmes ngjarjeve sociale, historive personale, duke e shndërruar kështu mjedisin në një hapësirë ndërveprimi, hapësirë të të nxënës e cila sugjeron veprimin dhe ndryshimin”¹¹

Hapësira brenda dhe jashtë institucionit duhet të reflektojë mbi natyrën e kësaj qasjeje, ku fëmijët mund të eksplorojnë të pavarur, ku zhvillohet kreativiteti, krijohet mundësia për punë në grup dhe atë individuale, respektohet aftësia dhe nevoja për të menduar¹². Fëmijët me mbështetjen e ateliehistes apo/dhe të edukatorëve mund të realizojnë idetë e tyre në formë artistike përmes materialeve të llojllojshme që përdoren në këtë qasje.

KRIJIMI I KONTEKSTEVE TË TË NXËNËS NË MJEDIS

Hapësirat, ndërtimi dhe organizimi i institucioneve të EFH-së janë të dizajnuara në atë mënyrë që t'i mundësojnë secilit fëmijë dhe secilit grup edukativ, të ketë në baza ditore mundësi të luaj, të eksplorojë, të zbulojë gjëra të reja, të komunikojë dhe zhvillojë raporte harmonike me bashkëmoshatarët, të rriturit dhe mjedisin.

Bazuar në parimet fundamentale që kanë të bëjnë me ndërtimin e marrëdhënieve dhe konstruktimin e të nxënës bazuar në eksperiencë përmes vëzhgimit dhe dëgjimit të të gjithë zërave, janë hartuar kritere të përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me karakteristikat e pëlqyeshme për krijimin e mjedisive cilësore¹³.

Në vijimësi janë paraqitur dhe sqaruar secilia nga këto karakteristika¹⁴:

Krijimi i mjedisive gjithëpërfshirëse

Në institucionet e EFH-së dhe KP ë me rëndësi është edhe ofrimi i mjedisive gjithëpërfshirëse për të gjithë pa dallim. Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës ku secili fëmijë është i vlerësuar dhe i pranuar është parakusht për edukim cilësor. Të gjithë fëmijët pa dallim kanë të drejtë të vijnë në institucionet e edukimit të hershëm prandaj çdo pengesë që mban ata larg kësaj mundësie është shkelje e të drejtave të fëmijës.

Qasja: Duke filluar nga infrastruktura fizike e institucionit edhe hapësirat e institucionit në përgjithësi duhet të jenë të përshtatshme për lëvizje për të gjithë fëmijët duke krijuar mundësi për t'ju përshtatur nevojave fizike si sigurimi i pjerrinave në pjesët hyrëse, mbajtëse, hapësira të cilat sigurojnë mundësinë për lëvizje të lirshme, hapësirë pa pragje dhe pengesa etj, dhe nevojat emocionale që nënkuptojnë mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e diskriminimit.

11 Edwards, C., Gandini, L., & Forman, G., (2012). The hundred languages of children: the Reggio Emilia Experience in transformation. Third editions. Praeger.

12 Kinney, L., & Wharton, P. (2008). An Encounter with Reggio Emilia: Children's Early Learning Made Visible. Abingdon, Oxon: Routledge

13 Edwards, C., Gandini, L., & Forman, G., (2012). The hundred languages of children: the Reggio Emilia Experience in transformation. Third editions. Praeger.

14 Edwards, C., Gandini, L., & Forman, G., (2012). The hundred languages of children: the Reggio Emilia Experience in transformation. Third editions. Praeger.

Krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës nuk mund të sigurohet përmes një aktiviteti të veçantë në ditë të caktuara, përkundrazi, krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës kërkon kohë, përkushtim dhe investim nga të gjitha palët si edukatorët, strukturat udhëheqëse të institucionit të EFH dhe KP e shkollës,, bashkëpunëtorët profesional, stafi teknik, prindërit, dhe madje komuniteti i gjerë dhe politikë bërësit.. Edukatorët/et me punën e tyre mund të shërbejnë si nismëtar/e për integrimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse përmes ndryshimeve të drejtëpërdrejta që ato i realizojnë në mjedisin fizik, social dhe organizimin ditor përgjithësisht.

Siguria: Krijimi i një mjedisi të sigurt në aspektin fizik e emocional është jetike që fëmijët të mund të zhvillojnë lirshëm potencialin e tij/saj. Krijimi i mjedisve të sigurta nënkupton krijimin e një mjedisi ku fëmija është i mbrojtur nga çdo formë e diskriminimit dhe pabarazisë. Siguria në aspektin fizik ka të bëjë me kontrollet e vazhdueshme të hapsirave fizike, mjeteve, lodrave, paisjeve me qëllim që të sigurohen që në mjedis nuk ka mjete, material të cilat cilat dëmtojnë shëndetin e fëmijës. Një kujdes të tejshtuar duhet të kemi në rastin e përdorimit të pjesëve të imta. Poashtu të rriturit duhet të ndërveprojnë me fëmijën me kujdes në mënyrë që t'i mbrojnë ata çdo formë e lëndimit.

Ka një dallim në mes të situatës së rrezikshme dhe krijimi të lojrave që kanë një shkallë rrezikshmërie. Psh. lojrat ku kërkohet ngjijtje, hedhje, kërcime janë lojëra që ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e fëmijës dhe duhet të realizohen, në këtë rast mbrojtja nga lëndimi ka të bëjë me bëjë në krijimin e mjedisit si vendosja e shtresave të buta poshtë, kufizimi i hapësirës, vëzhgimi i fëmijëve në lojë etj.

Siguria në aspektin emocional përfshin mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e diskriminimit për sa i përket: moshës, gjinisë, aftësive të fëmijës, racës, besimit fetar, prejardhjes/kombësisë, gjendjes civile të prindërve apo statusit social të fëmijës. Mjedis i në institucionet e EFH dhe KP duhet të siguroj mirëqenien e fëmijës dhe të ofrojë një mjedis të sigurt për të gjithë fëmijët padallim.

Mbështetëse për diversitet: Ofrimi i mundësive të barabarta nuk nënkupton vetëm ekspozimin e fëmijës ndaj të njejtave mundësi por ekspozimin e fëmijës ndaj mundësive që i përgjigjen interesave dhe nevojave që ai/ajo ka. Rregullimi i mjedisit duhet të promovojë diversitetin mes njerëzve dhe fëmijëve duke ofruar në një kënd fotografitë e familjeve të fëmijëve, ofrimin e librave, lodrave dhe materialeve që përfaqësojnë aftësi të ndryshme, tradita dhe kultura të ndryshme, etj.eshje të ndryshme për lojë me role që u mundësojnë fëmijëve të luajnë në mënyrë fleksibël duke pasqyruar kultura të ndryshme, gjëra të ndryshme shtëpiake që pasqyrojnë kultura dhe komunitete të ndryshme. Pranimi i ideve nga fëmijët dhe shndërrimi i tyre në projekte kërkimore. Krijimi i mjedisve të brendshme dhe të jashtme që e mbështesin fëmijën, përdorimi i një gjuhe të përshtatshme jodiskriminuese, krijimi i mundësive për bashkëveprim të vazhdueshëm me prindërit dhe komunitetin i kontribuojnë krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës.

Pranimi i dallimeve dhe promovimi i të veçantave tona, duke i mundësuar secilit fëmijë që të zhvillohet në përputhje me prirjet, talentet dhe mundësitë që ai/ajo ka është parim udhëheqës i punës cilësore në institucionet e fëmijërisë së hershme dhe KP-të, dhe gradualisht ndikon në krijimin e në kulture gjithëpërfshirëse.

Krijimi i një vendi të këndshëm (overall softness) – i referohet krijimit të një hapësire të qetë dhe harmonike. Zakonisht në institucionet e EFH-së dhe KP-të tradicionale hapësirat në mes të grupmoshave 0-3 dhe 3-6 kanë qenë të organizuara në atë mënyrë që të funksionojnë veçantë prej njëra tjetës, gjë e cila ka krijuar barriera komunikimi në mes të këtyre grupmoshave. Për të krijuar një mjedis sa më funksional dhe në funksion të krijimit të një hapësire për rritje dhe zhvillim të shëndetshëm në mes të këtyre dy grupeve, duhet të gjenden modalitete që grupmoshat 0-3 dhe ajo 3-6 të ndajnë hapësira të përbashkëta për kohë të caktuara. Kështu fëmijët do të bashkëpunojnë në mes vete në veprimtari të caktuara në mënyrë që të mësohen të punojnë së bashku, komunikojnë, dëgjojnë njëri-tjetrin dhe bashkëjetojnë duke respektuar njëri-tjetrin.



Fotografia 55. Hapësira të këndshme për ndërveprimin e fëmijëve nga grupmosha të ndryshme. IP Zambaku, Prizren
© UNICEF/2024

Një hapësirë racionale – përmes shkëmbimit të ideve, eksplorimeve, pyetjeve të shumta përmes një rrjeti me marrëdhënie dhe komunikim në mes të të rriturve dhe fëmijëve krijohet një ndërgjegjësim mbi vlerën e marrëdhënieve njërëzore.

Mjedisi rrethues dhe raportet shoqërore – është shumë e rëndësishme që veprimtaria e institucionit të EFH-së dhe KP-së të mos kuptohet si e fragmentizuar apo e ndarë nga bota jashtë. Përkundrazi është shumë e rëndësishme që jeta në institucion të EFH-së dhe KP të shtrihet përtej institucionit duke krijuar dhe kultivuar raporte harmonike me komunitetin, institucionet dhe organizatat të cilat veprojnë në qytet, p.sh. bibliotekat për fëmijë, parqet, muzetë, etj.

Ofrimi i përvojave ndijore – eksporimi përmes shqisave është njëra nga mënyrat përmes së cilës fëmijët fitojnë eksperiencë dhe ndërtojnë njohuritë e tyre; eksporimi përmes shqisave përdoret si rrugë individuale por edhe grupe për eksplorim të përbashkët dhe krijimin e njohurive të reja. Është shumë e rëndësishme të potencohet se kualiteti i mjedisit varet nga shumë faktorë nga të cilët mund të veçojmë: hapësira dhe format, organizimi funksional i mjedisit, eksperiencë shqisore, ngjyrat, dritat, materialet dhe përdorimi i tyre.

Fleksibiliteti dhe përshtatja – një hapësirë e të nxënës duhet të jetë e përshtatshme dhe të jetë fleksibile. Shpeshherë fëmijët gjatë lojërave dhe eksplorimit ndjejnë nevojën ta ndryshojnë atë dhe ta përshtatsin sipas një tjetër dimensionit që ata i kanë dhënë.

Ky fleksifiket krijon një mundësi të re të të nxënës prandaj edukatorët përmes pyetjeve, përgjigjeve, dialogut aktiv kuptojnë nevojat e fëmijës dhe ndihmojnë atë tutje.

Komuniteti dhe pjesëmarrja – fëmija është protagonist aktiv e cila merr pjesë aktive në jetën e institucionit të EFH-së dhe KP, ku së bashku me të rriturit, prindërit dhe edukatorët fëmijët funksionojnë si një bashkësi e cila në këtë rast është në shërbim të të gjithëve dhe jo vetëm fëmijës.

Konstruktivizmi social – institucioni i EFH-së dhe KP janë punishte apo laboratore në të cilat vazhdimisht ndërtohen njohurit. Nuk ka një linjë të caktuar e cila duhet të ndiqet në ndërtimin e njohurive. Edukatorët përmes vëzhgimit, kuptojnë interesat e fëmijës, përgatisin mjedisin e të nxënës dhe ndihmojnë fëmijën të jetë vetë-ndërtues i njohjes së tij. Duke i ofruar materialet dhe mjetet e përshtatshme dhe instruksionet e duhura, fëmija përfshihet aktivisht në procesin njohës në bashkëpunim me bashkëmoshatarët dhe të rriturit.

Dukshmëria dhe transparencia – në institucionet sipas qasjes Reggio Emilia, që në hyrje të institucioneve, vërehet pjesëmarrja aktive e fëmijës dhe roli i edukatorit në përgatitjen e mjedisit dhe zhvillimin e projekteve përmes komunikimit me anë të punës së fëmijës dhe dokumentimit të punës së tyre dhe rregullimit të hapësirës. Transparenca në punë dhe lirishtëria e lëvizjes të krijon pikëpamje të qarta mbi lirinë e fëmijës për të qenë protagonist në procesin e saj të zhvillimit dhe të nxënës.

Pasurimi i përditshëm – gjatë punës me fëmijë në baza ditore edukatorët vëzhgojnë dhe dëgjojnë fëmijët deri sa ata eksplorojnë dhe zbulojnë botën përrreth. Në një mjedis të organizuar mirë fëmijët kanë shumë mundësi për të menduar dhe reflektuar me thellë. Harmonizimi i veprimeve të edukatoreve, stimulimi i fëmijës për të nxënës, përgatitja e mjedisit, zhvillimi i ideve kreative mbi projektin, vëzhgimi, dokumentimi janë të gjitha veprime të cilat me një dashuri dhe kujdes nga ana e edukatores arrijnë të përgatisin fëmijët për botën e të nesërmës.

TRANSFORMIMI I MJEDISIVE

Edukatori/ja bazuar në vëzhgimin dhe dokumentimin e bërë i ofron fëmijës mundësi që ajo të eksplorojë dhe eksperimentojë me materialet. Lindja e një projekti apo zhvillimi i një koncepti të ri për fëmijën mund të vijë nga shumë rrugë, e njëra ndër to është edhe krijimi i alternativave përmes përgatitjes së mjedisit. P.sh. edukatori/ja ka vëzhguar fëmijën që gjatë kohës së qëndrimit në natyrë, fëmija ka vëzhguar me kujdes drunjët dhe një kohë të gjatë ka shikuar përmes të qarave tek lëvozhga e drurit. Kjo sekuencë e mbajtur shënim dhe e dokumentuar mund t'i shërbejë edukatorit/es si një stimul fillestar për ta vëzhguar fëmijën nëse ai ka interes për të hulumtuar tutje botën e gjallë, drunjët dhe insektet që gjinden në të. Nëse interesimi i fëmijës vazhdon edukatori/ja duhet të krijojë një kontekst në mjedisin e dhomës prej nga fëmijës mund t'i bëhet oferta për të hulumtuar dhe zhvilluar tutje idenë e tij fillestare mbi drunjët dhe insektet.

Organizimi i mjedisit në përputhje me nevojat e grupit edukativ

Mjedisi në institucionet e fëmijërisë së hershme duhet të jetë fleksibil dhe t'i përshtatet nevojave, interesave dhe aftësive të secilit fëmijë. Në shumicën e rasteve, interesat e fëmijeve mund të ndryshojnë shpesh apo mund të jenë të ndryshme. P.sh. Një pjesë e grupit mund të ketë interes me shumë për kafshët dhe një pjesë tjetër të ketë interes në një aktivitet që përfshin lojën me ujë gjatë stinës së verës. Në raste të tilla hapësira mund të jetë e pamjaftueshme apo e kufizuar për nevojat e ndryshme të grupit. Prandaj, hapësirat e klasës/grupit duhet të japin përgjigje për të gjithë interesat e fëmijeve. Është e rëndësishme që edukatorja të jetë kreative në transformimin e mjediseve dhe përshtatjen e tyre për interesat e secilit fëmijë. Materialet/ hapësirat gjithëpërfshirëse janë ideale për të përgjigjur nevojat dhe kërkesat të ndryshme të fëmijeve. Transformimi i mjediseve në hapësira gjithëpërfshirëse mund të bëhet si në mjedisin fizik ashtu edhe atë organizativ, rregullimin dhe ri-sistemimin e qendrave të aktiviteteve, riorganizimin e vendosjes së hapësirave të punës, poashtu

pasurimin e hapësirës me materiale të tjera, vendosjen e tiktave të ndryshme me ilustrime për orientim, ndryshimet në rutinat ditore me qëllim të përshtatjes ndaj nevojave të fëmijës, etj. Këto transformime realizohen përmes vëzhgimeve të edukatorës dhe nuk duhet të jenë domosdoshmërisht ndryshime të mëdha. Përmes vëzhgimit të fëmijeve gjatë aktiviteteve apo përmes bashkëbisedimeve me prindërit/kujdestarët ligjor, edukatorët mund të jenë me të përgatitura për transformimin e mjediseve gjatë javës, ditës, madje edhe gjatë aktivitetit sipas nevojave dhe interesave të fëmijëve.



Fotografia 56.

Asistimi i fëmijës me aftësi të kufizuara gjatë realizimit të aktivitetit (Handikos)



Asistimi i fëmijës me aftësi të kufizuara gjatë realizimit të aktivitetit (Handikos)


Ashtu sikurse mjedisi i jashtëm që mund të nxitë fëmijën në hulumtimin dhe eksplorimin e gjërave, edhe krijimi i konteksteve në hapësirat e brendshme mund ta bëjë një gjë të tillë. Ndonjëherë kureshtja e fëmijës për të hulumtuar një dukuri fillon në mjedisin e jashtëm, pastaj vazhdon dhe zhvillohet mendimi përmes eksplorimit në mjedisin e brendshëm dhe përsëri kthehet në mjedisin e jashtëm për të verifikuar apo krahasuar të dhënat. Fëmija është i lirë të gjejë mënyrat përmes së cilës atij/asaj i pëlqen të bëjë gjërat, Kështu fëmija është duke konstruktuar ditë pas ditë të nxënies së tij rreth botës që e rrethon. Fëmijëria e hershme nuk është vetëm përgatitje për shkollë por është tërë jeta e fëmijës, e tashmja dhe e ardhmja e saj.

Ofrimi i materialeve të duhura në kohë të duhur për fëmijën, janë mënyra më e natyrshme përmes së cilës fëmija zhvillon procesin e tij njohës. Përmes lojës, eksplorimit, provave me materiale të ndryshme, ndërveprimit me bashkëmoshatarët dhe të rriturit të nxënies zhvillohet qëndrueshëm dhe natyrshëm.

Sygjerohet që në projektimin e mjedisit duhet të përfshihen edhe përdorimi i ngjyrave, dritës, tingujve/zërit dhe aromës. Jo vetëm rregullimi i hapësirës por edhe ofrimi i materialeve shqisore që kanë të bëjnë me ngjyrat, dritën, tingujt dhe aromën korrespondon me proceset njohëse të fëmijëve¹⁵.

Përdorimi i ngjyrave – për përdorimin e ngjyrave preferohet një gamë kromatike më me shumë nuanca sesa vetëm tre ngjyrat bazë. Përzgjedhja dhe ofrimi i nuancave duhet të jetë më i gjërë me një skemë me më shumë ngjyra të përzgjedhura me kujdes.

Përdorimi i dritës – ndriçimi në institucion është e preferueshme të jetë me dritë natyrale duke ofruar mundësi që drita të deportojë në hapësirat e brendshme jo vetëm nga një kënd i dhomës. Përveç përdorimit të dritës së diellit edhe një varg situatash të reja të të nxënies mund të krijohen nga përdorimi i burimeve artificiale të dritës duke ofruar një llojllojshmëri burimesh si dritë fluroshente, halogjene, etj. Burimi i dritës duhet të jetë në gjendje që të krijojë hije, ku drita është e përqëndruar.



Fotografia 57.
Përdorimi i dritës për eksplorimin e fotografive. IP Shkronjat, Prishtinë
©UNICEF/2024

Edhe përdorimi i **reflektimeve përmes pasqyrave** dhe materialeve të tjera përmes të cilave krijohet pasqyrimi zgjojnë kureshtjen e fëmijëve për të eksploruar dhe zbuluar¹⁶. Ata mund të shohin nga një tjetër perspektivë fillimisht vetën e tyre dhe më pas mjedisin e reflektuar në pasqyrë, lëvizjen e të tjerëve në hapësirat e dhomës dhe gjithë kjo eksperiencë krijon një prespektiv tjetër në mendjen e fëmijës.

Përdorimi i materialeve – materialet duhet të jenë të llojllojshme, në mënyrë që të krijojnë një mjedis shumëndijor duke stimuluar zhvillimin përmes shqisave, prandaj ofrohen sipërfaqe të lëmuara, sipërfaqe më pak të lëmuara, të vrazhda, të lagura dhe të thata, të errëta, të ndryshme, të tejdukshme dhe transparente. Ato nuk duhet të krijojnë apo fuqizojnë ndasi dhe stereotipe gjinore, por duhet të promovojnë gjithëpërfshirjen dhe barazinë gjinore.

Nuk ka një mënyrë të vetme të përdorimit, rregullimit dhe ofrimit të materialeve në mënyrë që të nxitë dhe stimulojë të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë, në të njëjtën mënyrë, prandaj edukatorët duhet të jenë të kujdeshëm në propozimet e bëra, gjithmonë duke u bazuar në vëzhgime dhe konsultime me koleget, atelieristën, pedagogen, por edhe prindërit.

¹⁵ Zini, M. (2005). See, hear, touch, smell, and love. Children in Europe, 8, 22-24.

¹⁶ Thornton dhe Brunton (2010) Understanding the Reggio Approach: Early years education in practice. Routledge. <https://doi.org/10.4324/9781315744018>



Fotografia 59.
Prezantimi i materialeve të aktivitetit tek grupmoshat 0-2
(Shkronjat, Prishtinë)
© UNICEF/2024

Materialet që mund të ofrohen në institucion të EFH-së dhe KP

Kriteret që duhet t'i plotësojë një material si parakusht që fëmijët të mund të punojnë me të ndërlidhen me kriterin e sigurisë. Nëse materiali nuk i sigurt për shëndetin dhe sigurinë e fëmijës atëherë ai material nuk mund të përdoret. Në të gjitha rastet tjera çdo material që edukatori/ja e konsideron burim të rëndësishëm për procesin e eksplorimit të fëmijës mund të përdoret. Materialet gërshetohen njëra me tjetrën dhe në varësi të observimeve të bëra, njohjen e interesit të fëmijës i ofrohen si propozim për eksplorim.

Në grupet e materialeve që mund të përdoren janë:

Materialet nga druri (një shembull i klasifikimit):

- të përpunuara: boqa pishe, stika pishe, shkopinjë, copëza druri dekorativ, etj.
- gjysëm të përpunuara: copëza druri të mëdha të prera në formë të cilindrave me madhësi të ndryshme, petëza druri të vogla të prera në 1 cm madhësi, etj.
- të përpunuara: kube druri të madhësive të ndryshme, cilinda dhe trupa të tjerë gjeometrik.
- Enë të ndryshme druri të madhësive dhe formave të ndryshme, lugë druri, rrathë druri, etj.

Materiale të ndryshme nga letra:

- Letër e zakonshme (80 gr.) ngjyra nga e bardhe deri në të zezë.
- Letër më e trashë (100 gr.) ngjyra nga e bardhe deri në të zezë.
- Letër e kuzhinës.
- Letër pëlhurë e bardhë
- Letër thithëse
- Letër ambalzhi
- Pluriball
- Kartona me tekstura dhe ngjyra të ndryshme (Mozaik me grafikë, fjalë, materiale, Reggio Emilia, 2021)

Materialet nga qelqi:

- Të ripërdorshme: kavanoz të madhësive të ndryshme, vazo të të ndryshme nga qelqi i tejdukshëm, gota të tejdukshme, enë të ndryshme qelqi, të tejdukshme dhe me ngjyrë.
- Guralec qelqi me ngjyra dhe madhësi të ndryshme, etj.

Materiale të fabrikua:

- Lapsa të ngjyrave dhe formateve të ndryshme
- Ngjyra të llojeve dhe formateve të ndryshme
- Bojëra të llojave të ndryshme
- Argjilë
- Brusha dhe mjete tjera ndihmëse për përpunimin e argjilës.

- Materiale tekstili të teksturave të ndryshme
- Letra të madhësive dhe teksturave të ndryshme

Materiale të ripërdorshme:

- Materiale nga plastika, kartoni, metali, dhe të tjera të cilat mund të sigurohen me një bashkëpunim me familjen dhe komunitetin.

Krijimi i një konteksti është një ftesë për fëmijën që të eksplorojë, hulumtojë dhe krijojë. Një konteksti i tillë duhet kuruar me kujdes dhe të prezantohet bukur nga edukatori/ja, kështu tërhiqet vëmendja e fëmijës dhe fëmija natyrshëm përfshihet në eksplorimin e materialeve dhe ideve.

Krijimi i një konteksti të tillë dallon nga qendrat e aktiviteteve sepse këtu edukatori/ja është e orientuar dhe vëzhgon procesin e të nxënësit nëpër të cilin fëmija po kalon, duke vendosur theksin në procesin e jo domosdoshmërisht në rezultatin e arritur. Kjo përfshin edhe parimet dhe vlerat që duhet t'i bart konteksti i krijuar, posaçërisht parimet si fëmija në qendër dhe fëmija hulumtues, gjithëpërfshirja, barazia gjinore, etj.

Përdorimi i burimeve natyrore dhe dhënia e mundësive të fëmijëve për t'u angazhuar me natyrën do t'i ndihmojë fëmijët të zhvillojnë respektin për natyrën dhe të bëhen të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

Perspektiva e të kuptuarit të fëmijës si individ me të drejta të patjetësueshme, të kuptuarit dhe zbatimi i konceptit mbi 100 gjuhët, përgatitja e mjedisit, zhvillimi i projekteve edukative, observimi dhe dokumentimi, bashkëpunimi me prindër dhe komunitet janë komponentet thelbësore të cilat nëse realizohen praktikisht me një kompetencë të lartë profesionale i japin rolit të edukatorëve peshën dhe rëndësinë që ju takon.

Si ta shndërrojmë mjedisin në edukatorin e tretë të fëmijës?

Mobiljet dhe paisjet:

1. Dollapa me raftë të hapura me ndarje të ndryshme (disa raftë me të ngushta, disa më të gjëra)
2. Karrige

3. Tavolina rrethore
4. Tavolina katrore
5. Tavinë për lojëra sensorike
6. Tavinë me dritë
7. Raft i pjerrët për ekspozimin e librave
8. Kavaletë (eng. Easels)
8. Dollap në formë gardarobe (dy hapësira, njëra për gjërat personale, tjetra për çantën dhe hapësira për varëse)
9. Shtretërit që duhet të jenë të rrafshët dhe që vendosen njëri mbi tjetrin për të maksimizuar shfrytëzimin e hapësirës. Mund të jenë shtresa të buta në vend të shtratit tradicional, posaçërisht për moshat 3-6 vjeç.

Shënim për 1-9: Orenditë është e rekomanduar të jenë nga druri dhe me ngjyrë druri. Në varësi të grupmoshës dallojnë për kah lartësia orenditë për fëmijët deri në 2 vjeç, 3-4 vjeç dhe 4-6 vjeç.

10. Jastëk të vegjël (së paku 15) për grup
11. Tendë që varet ose që montohet.

Libra:

1. Libra me faqe të trasha për fëmijët deri në 3 vjeç që trajtojnë tema të ndryshme.
2. Enciklopedi të ndryshme me tematika të ndryshme.
3. Libra që trajtojnë tematika të ndryshme nga bota e fëmijëve, përfshirë ato që pasqyrojnë vlerat si gjithëpërfshirja, barazia gjinore, diversiteti, por edhe me gjërë (Kujdes: JO përralla klasike si Borëbardha, Kësulkuqja, por libra të cilët përcjellin një mesazh pozitiv tek fëmijët, libra të cilët i ndihmojnë fëmijët të zgjidhin problem nga jeta e përditëshme si p.sh. aëria e librave "Le të flasim hapur", "Të kujdesemi për planetin", "Miq të deborës"; "Shtëpia e iriqit të vogël", etj.)

Materiale nga druri

- Shporta të thurura për klasifikimin e materialeve të madhësive të ndryshme.
- Shkopinjë druri të madhësive të ndryshme.

- Kube druri të madhësive të ndryshme, cilindra, kuboid, dhe trupa të tjerë gjeomerik.
- Copëza druri të prera në formë të cilindrave me madhësi të ndryshme.
- Petëza druri të vogla të prera në 1 cm madhësi, etj.
- Enë të ndryshme druri të madhësive dhe formave të ndryshme, lugë druri, rrathë druri me madhësi të ndryshme, piata druri të madhësive të ndryshme. etj.

Materiale nga letra:

- Letër e zakonshme (80 gr.) ngjyra nga e bardhe deri në të zezë.
- Letër më e trashë (100 gr.) ngjyra nga e bardhe deri në të zezë.
- Hamera
- Letër Flip-chart
- Letër e kuzhinës.
- Letër pëlhurë e bardhë
- Letër thithëse
- Letër ambalzhi
- Pluriball
- Kartona me tekstura dhe ngjyra të ndryshme
- Letër vetëngjithëse
- Zarfe të madhësive të ndryshme
- Qese letre

Materiale të tjera të ndryshme:

- Lapsa me trashësi të ndryshme (nga ngjyra e bardhë deri në të zezë)
- Makinë mprehëse
- Goma
- Ngjyra druri
- Ngjyra pasteli
- Ngjyra uji
- Ngjyra tempero
- Fllamastera
- Markera
- Argjilë
- Paletë për përzierjen e ngjyrave
- Brusha të madhësive të ndryshme
- Sfungjer të madhësive të ndryshme për stampim
- Mjete pune për punimin e argjilës
- Shkumsa me ngjyra
- Kapse letre (Staple)

- Kapse për letër
- Ngjithës shirit
- Ngjithës i lëngshëm
- Ngjithës për letër
- Ngjithës druri
- Gërshër të mëdha
- Gërshër të vogla (për fëmijë)
- Vizore dhe këndmatës

Materialet nga qelqi:

- Kavanoza të madhësive të ndryshme,
- Vazo të të ndryshme nga qelqi i tejdukshëm,
- Menzurë,
- Enë të ndryshme qelqi, të tejdukshëm dhe me ngjyrë.
- Guralec qelqi me ngjyra dhe madhësi të ndryshme

Paisje/lodra/materiale të tjera:

- Mikroskop (që mund të lidhet me laptop)
- Peshore kuzhine me tregues (ose digjitale)
- Lente zmadhuese
- Pikatore
- Pinceta
- Kalkulator
- Magne
- Penjë të trashësive të ndryshme,
- Gjilpëra me vrimë të madhe,
- Puzzle druri (me tematika të ndryshme)
- Puzzle kartoni (me tematika të ndryshme)
- Set lodrash me kafshë të fermës
- Set lodrash me kafshë të egra
- Set lodrash me kafshët e ujit.
- Set i veglave të punës për kopshtari
- Set enëve të kuzhinës nga metali dhe i ngjashëm me enet prej vërteti
- Set i veglave të punës për ndërtimtari
- Set i mjeteve të punës së mjekut
- Set i mjeteve të punës nga shkenca
- Set i mjeteve të punës për pastrim
- Topa të vegjel për lojra në grup
- Top futbolli, basketbolli, hendbolli
- Rrathë të mëdhenjë

SI TË REFLEKTOJMË MBI MJEDISIN E TË NXËNIT?

Reflektoni mbi mjedisin në institucionin tuaj tuaj të EFH-së ose klasën parafillore nga pikëpamja e fëmijës, duke përdore pyetjet si:

- A ka çdo hapësirë në insitucionin tuaj një qëllim të veçantë?
- A është e organizuar çdo hapësirë brenda insitucionit tuaj?
- A shfrytëzohet çdo hapësirë në institucionin tuaj si brenda ashtu edhe jashtë?
- A është mjedisi jonë ndihmës apo pengues në aktivitetet që duam t'i realizojmë?
- A mund t'i sjellim materialet nga mjedisi i jashtëm brenda dhe ato nga mjedisi i brendshëm jashtë?
- Çfarë ndryshime do të mund të realizonim me qëllim të përmirësimit të hapësirave dhe shfrytëzimit racional të tyre?

Reflekto me shkrim dhe ndërto një plan veprimi për ndryshimet e mundshme!

Falënderime

Shprehim mirënjohjen e thellë për kontributin e vlefshëm të të gjitha kopshteve që kanë dërguar fotografi për manualin e organizimit të mjedisit. Materialet e siguruara kanë qenë një burim i rëndësishëm për pasurimin vizual të manualit dhe për ofrimin e shembujve konkretë të praktikave të mira në organizimin e ambienteve edukative. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një udhëzuesi gjithëpërfshirës që do të shërbejë si referencë e vlefshme për përmirësimin e mjediseve edukative.

